


BIBLIOTEKA

8H-2
H 91



NË EMËR TË
LUMTURISË

DRAMË

ISMAIL HOXHA

8915-2
H 91

ISMAIL HOXHA

5

R

NË EMËR TË LUMTURISË

(Dramë në dy pjesë)

46886

LIBOTEKA NË SHTEPË
GJEROKASTRI

35934

Tirageja 3000 kopje Përmbajtje 10x100/95 Stampa: Shkodra-95

Sipas NISP Sipas Kategorisë «MILAT DUTI»
SHTEPIA BOTONJESË «NAIM FRASHERI»

8-2128
10 H

NE EME^Р
TE LUMURIS^Е

(Балк. јд. Јанко Џ.)

Tirazhi 2888 kopija Format 76x106/32 Stash: 2204-00

Shtyp NISh Shtypshkronjave «MIHAL DURI»
Stabilimenta = NENTORI = Tirane, 1968

I kushtohet dëshmorëve të Luftës
nacional-çlirimtare

A u t o r i

PERSONAZHET

1. Nëna
2. Skënderi
3. Shpresa
4. Kopshtari
5. Alfredi
6. Koloneli OTTO
7. N/Togeri Hans
8. Rreshteri Robert.

Të rinj revolucionarë, oficerë dhe ushtarë gjermanë.

Ngjarja zhvillohet gjatë viteve të luftës në një nga qytetet kryesore.

PJESA E PARE

Tablo e parë

Dritat e prozhektorit ndriçojnë në skenë një lapidar të mbuluar me tufa lulesh të freskëta, të cilat, nga mënyra se si janë vendosur, të lenë përshtypjen se aty kanë ardhur me qindra e qindra vizitorë.

Mbi pllakën e mermertë të lapidarit, të shkruara me gërma të dukshme, lexohen këto fjalë, që citohen me qartësi në altoparlant nga një spiker me zë baritonin:

— Këtu në maj të vitit 1944, nga nazistët gjermanë u pushkatua dashuria e dy të rinjve, që i dhuruan atdheut atë çka ishte më e shtrenjtë, jetën e tyre të re.

Ndërsa spikeri i thotë këto fjalë, që shoqërohen me tingujt e një marshi funebër, nga salla ngjitet drejt lapidarit një grua në moshë të thyer e veshur në të zeza, që mban në duar një tufë karafilash. Ende pa iu afruar ajo lapidarit, spikeri (**ky mund të zëvendësohet edhe me një konferencier**) thotë:

— A e shihni këtë grua? Kjo aq shumë e ka lidhur kujtimin e saj me këtë lapidar sa... prisni, ju lutem. Prisni!

Në këtë kohë gruaja e veshur me të zeza gjunjëzohet para lapidarit, vendos karafilat dhe, ashtu e gjunjëzuar siç është, ka përqëndruar vështrimin e saj diku thellë dhe është kredhur në mendime. Spikeri vazhdon (**spektatorëve**):

Qetësi, qetësi...

Ndërkaq, nën tingujt optimistë të një melodie me kitarë, dëgjohet një zë i qartë prej të riu — sikur të flasë lapidari:

— Nënë! E dashura nënë! Fshi lotët! Fshi lotët, nënë! Nuk është mirë kështu! Armiku sheh... Fshi lotët, nëna ime e mirë... Ne do të rrojmë edhe kur të vdesim... Lamtumirë... Lamtumirë, nëna ime e shtrenjtë.

Në këtë çast gruaja e veshur me të zeza çohet dhe, duke u drejtuar nga salla, fshin lotët; kur papritur shikon plot spektatorë. Ajo, e habitur, u drejtohet të pranishmëve:

— Më falni...! Unë nuk desha... Më falni. Unë tani po largohem; (bën disa hapa përpara përtë zbritur nga skena, por hapin e saj e ndërpresin zëra të ndryshme që vijnë nga salla nëpërmjet altoparlantit).

Zërat — Jo, jo, flisni. Tregonani si e qysh.

Gruaja e veshur me të zeza — Po përse? Këto i përkasin së kaluarës.

Zërat — Jo, jo, flisni. Tregonani si e qysh. të dimë gjithshka, gjithshka (fjalët e spektatorëve, që thuhen në altoporlant, duhet të jenë të qarta).

Gruaja e veshur me të zeza: — E mirë, pra. Historia e këtij lapidari që po shikoni ose, më mirë, e kësaj dashurie nis kështu:

* * *

Në këtë moment gruaja e veshur me të zeza
hap siparin, kurse lapidari zhduket.

Tani dekor i paraqet në skenë një mbrëmje të bukur. Nën kupën e qiellit të kaltërt apo kanë ndriçuar yjet. Flladi i erës përkëdhel fytyrat e dy të rinxve, atë të Skënderit dhe të Shpresës, që janë vendosur në distancë, ballë për ballë njeritjetrit, i pari nga e djathta, kurse e dyta nga e majta.

SHPRESA — (duke soditur me kënaqësi qiellin, numëron yjet.) Dhjetë, njëzet, pesëdhjetë,
Oj ç'mrekulli! Qindra e mijëra yje të bukura
na buzëqeshin e na vështrojnë! Të duket
sikur i ke në pëllëmbë të dorës dhe luan
me to. Kurse ato qëndrojnë larg nga ne,
atje lart, lart, mu në kupë të qiellit! E,
megjithatë, na buzëqeshin. Sa interesant!
(vazhdon të numërojë). Pesëmijë... dhjetë-
mijë, njëqindmijë yje...

SKËNDERRI — (duke jetuar botën e tij, i drejtuhet spektatorit. Në dorë mban një trifil). Ju që
keni dashuruar ose që dashuroni, sigurisht
ju ka rastisur të gjeni trifilin me katër
fletë! Sa vështirë është ta gjesh këtë bimë
të rrallë! Po kush dashuron do ta gjejë. Me
siguri do ta gjejë. Ja, unë, më së fundi, e
gjeta. E kërkova vite me radhë dhe e gjeta.
Sa çudi!

SHPRESA — Oj, sa bukur!... Skendo, Skendo!
Pa shih se si lëviz një yll! (**e habitur**). Unë
s'kam parë kurrë se si lëvizin yjet!

SKËNDERRI — Thonë, se ai që e shikon i pari yllin
në lëvizje, bëhet i lumtur.

SHPRESA — Me të vërtetë?

SKËNDERI — E kam me gjithë mend.

SHPRESA — (e gëzuar). Atëhere unë do të jem e lumtur! Po pse lëvizin yjet?

SKËNDERI — Pse lëvizin...! Lëvizin se... sepse nuk mund të qëndrojnë në një vend. Ato janë yje... nuk janë si ne.

SHPRESA — Pse, si jemi ne?

SKËNDERI — Ne?... Si dy zogj të vegjël që presim të na rriten krahët dhe të fluturojmë.

SHPRESA — Kurse mua, Skendo, e di si më duket? Sikur kam pushtuar tërë botën. (**tregon pëllëmbën**). Ja, këtu e kam dhe mund ta vërtis si të dua. (**i afrohet Skënderit**). Mund ta hedh në hapësirë (**bën sikur e hedh**), dhe ta pres, prapë ta hedh dhe prapë ta pres. Kaq e fuqishme jam bërë sot! (**i afrohet pranë**)... Jam kaq e gëzuar sa... (**hidhet nga gëzimi dhe pushton me krahë një pemë aty pranë**). Do të doja të kisha fletë dhe të ngjitesha lart, lart, drejt yjeve. Sa mirë do të ishte sikur njeriu të kish fletë.

SKËNDERI — (me shaka). Në vend të këmbëve.

SHPRESA — Ti bën shaka, Skendo, ndërsa unë...

SKËNDERI — Aspak. E kam megjithë mend. E ç'i duhen këmbët atij njeriu, kur ai nuk është i aftë të ecë me to?

SHPRESA — S'kuptoj asgjë!

SKËNDERI — Koha është më e shpejtë se njeriu, Shpresa. Njeriu duhet ta arrijë e të ecë së bashku me të. Përndryshe, furtunat e jetës mund ta përlajnë njeriun, ta hedhin tej dhe ta bëjnë palmuç.

SHPRESA — Prapë s'kuptoj asgjë!... Unë dua krahë, Skëndo. Dua të fluturoj, që të fshihem lart mbi retë dhe të rroj me ëndërrat e mia.

SKËNDERI — Të shkëputesh nga tokë? Të largohesh nga njerëzit?

SHPRESA — Jo, jo. Nuk desha të them këtë. Tjetër gjë dua të them... Unë tokën e dua shumë, edhe njerëzit i dua shumë. Por ja që ngadonjëherë njerëzit të vihen pas dhe nuk të lenë të lirë të ëndërrrosh për atë çka ndjen. Kurse atje lart në mes të yjeve... Po ç'flas unë budallaqja kështu...

SKËNDERI — Po ti mos u nxito, Shpresa, më ngadalë. E pastaj?

SHPRESA — E pastaj, dua fletë të fluturoj si retë. Ja, kështu. (hidhet e gëzuar, por në këtë moment i bie në tokë stilografi dhe i thyhet). Hop la, u thye (me keqardhje). Sa e marrë që jam!

SKËNDERI — (i buzëqeshur). S'kà asgjë të keqe. Shenjë e mirë.

SHPRESA — Shenja e mirë qenka të të thyhet ky kujtim kaq i bukur.

SKËNDERI — Kur të zotit i thyhet diçka që ai e çmon shumë, është shenjë lumturie. Pastaj gjëra që ndodhin. Thyhen njerëz e jo më një pendë.

SHPRESA — Më këtë (tregon stilografin) unë Skendo ëndërrroja të shkruaja dhjetëra faqe për dashurinë...

SKËNDERI — Fort bukur, Shpresa. Dashuria është një ndjenjë e fuqishme. Ajo është, si të thuash, një mikeshë e mirë që vete tek ata

që e duan jetën dhe që përpinqen të bëjnë për të diçka, fjala vjen, diçka më të guximshme se sa fenomenet e zakonshme.

SHPRESA — Kështu më duket edhe mua.

SKËNDERI — Ja p.sh. shqiponja e dashuron shumë jetën. Ajo thonë se jeton 500 vjet!

SHPRESA — Pesëqind vjet!

SKËNDERI — Po, pesëqind vjet. Dhe kur i vjen vdekja, si trimëreshë ajo çan drejt qiellit. Ngjitet e ngjitet, gati gjer tek yjet dhe si heroinë pérplaset në tokë, për të jetuar pasi të vdesë.

SHPRESA — Ç'vdekje heroike me të vërtetë!

SKËNDERI — Është dëshuria për jetën që e bën kaq të guximshme shqiponjën. Pa mendo tani se sa të madhërishëm mund ta bëjë dashurija njeriun, kur ai di të nderojë atë.

SHPRESA — Sa gjëra interesante që përban,jeta! Ja përsë duhet tëndërruar, përsë duhet shkruar. (sheh pendën). Kurse kjo u thyel Po kësaj ç'ji thonë?

SKËNDERI — Shenjë lumturie!

SHPRESA — Shenjë lumturie!... Po ç'është lumturia?

SKËNDERI — Lumturia?... Si ta them unë,,
Lumturia është... Ja ku po vjen Alfredi.

ALFREDI — (Duke ardhur nga thellësia e skenës,
i drejtohet Skënderit dhe Shpresës). Akoma ju!
Bini shkurt, djema. Mos u merrni me filozofi. Në jetë duhet gjetur rruga më e afërt.

SHPRESA — Ne po bisedojmë për lumturinë,
Alfred.

ALFREDI — Pallavra! E kush e gjeti atë që ta kërkoni ju? Lumturia është gënjeshtër. Njerëzit më kot, kur ngrenë dolli, urojnë për lulëzimin e saj.

SHPRESA — Me të vërtetë edhe mua kështu më duket ngandonjëherë.

ALFREDI — Duhet parë bota ashtu siç është. Ajo, me të vërtetë është e gjerë, por rrugët i ka të ngushta.

SKËNDERI — Jo, nuk është ashtu. Kjo botë s'është ndërtuar drejt! Të jetosh për një copë bukë të mykur, siç jetojnë tek ne dhe të ushqehesh vetëm me rreze dielli, kjo s'është lumturi... Lumturia duhet të jetë gjësim për të gjithë. Por atë e kanë lidhur me pranga dhe nuk e lenë të takohet me njerëzit...

ALFREDI — Oouu? Tani na fute në të thella. Shkova unë. Natën e mirë (del).

SHPRESA — Po mirë, Skendo! Po ç'duhet të bëjë njeriu për lumturinë. Ti, p.sh., ç'mund të bëje për lumturinë.

SKËNDERI — Unë? Ti i do shumë yjet. A s'është kështu?

SHPRESA — Po, i dua shumë.

SKËNDERI — E, pra, unë për ty mund të ngjitesha në kupë të qiellit, të zgjidhja atje yllin më të bukur e të ta sillja ty, që të bëheshe e lumtur, plotësisht e lumtur.

SHPRESA — Të ngjitesh deri në kupë të qiellit!

SKËNDERI — Deri në kupë të qiellit, Shpresa. Lumturia meriton çdo sakrificë.

SHPRESA — Ç'kënaqësi të jesh pranë teje, Skendë. (e qafon). Kështu, gjithmonë kështu.

Sa lehtë e ndjej veten. Merre kitarën, Skëndo, merre. Kam dëshirë të sodis yjet. (Skënderi merr kitarën dhe luan sonatën e Betovenit). Një oqean i tërë ndjenjash është dëfdhur në këtë muzikë! A nuk të duket ty, Skendo, se në meloditë e kësaj pjese është fshehur lumturia? Po ti vazhdo, vazhdo, (Pas një pauze). Sikur të fluturoja edhe unë si meloditë e kësaj sonate!

KOPSHTARI — (Ndodhet brenda në skenë kur fillon të luajë në kitarë Skënderi. Atë e ka tërhequr atje melodja e bukur, të cilën e dëgjon me shumë kënaqësi. Pasi imbaron Skënderi, ai u flet dy të rinxje që, të futur thellë në botën e tyre, sikur tremben). Falemnderit, djalosh, ma qetësove shpirtin.

SKËNDERI — Na falni, xhaxho.

KOPSHTARI — Unë ka shumë kohë që s'kam dëgjuar muzikë kaq të bukur! Unë jam kopshtar dhe jetoj me tingujt e ëmbël të zogjve, por ata tanë kanë ikur, nuk këndojnë më dhe, siç e shihni, kam mbetur vetëm. Tingujt tuaj më zgjuan. Falemnderit. Falemnderit shumë.

SKËNDERI — Xhaxho...!

KOPSHTARI — Tani shkonit në shtëpi. Është vonë. I tërë qyteti fle. Ai ka rënë në qetësi. (Bie ora e qytetit).

SKËNDERI — Jo, xhaxho. Qetësia është prishur. (Në këtë çast dëgjohet një zhurmë e madhe aeroplanësh që sa vjen shumohet dhe shumohet. Sidomos ajo bëhet më e llahtarshme, kur aeroplanët kalojnë mbi kokat e njerëzve, disa nga të cilët, të alarmuar, kanë

dalë jashtë. Në mes të tyre spektatori dallon nënën e Skënderit dhe doktorin, babanë e Shpresës, që banojnë diku aty afër kopshti. Ata thërrasin:

NËNA — Skënder! Skënder!

DOKTORI — Shpresa! Shpresa! moj bijë!

(Thirrjen e këtyre prindërve e ndërpërt Al-fredi, i cili, i tmerruar, është kthyer nga rru-ga. Ai i drejtohet Skënderit dhe Shpresës me këto fjalë):

ALFREDI — Ç'më rrini këtu? A nuk po shikoni se ç'bëhet?! (Tani pothuajse zhurma e aeropla-nëve është zhdukur. Në skenë si blok janë vendosur në mënyra të ndryshme Skënderi, Shpresa, nëna, doktori, Alfredi dhe kopsh-tati. Çdo njeri nga ata do të shprehë pak a shumë qëndrimin e tij ndaj kësaj ngjarjeje, që paralajmëron praktikisht fillimin e luftës).

KOPSHTARI — Po. Qetësia u prish. Por i lumtur është ai që mund t'ja u kthejë atë prapë njerëzve.

DOKTORI — Unë kam vetëm një vajzë — Shpre-sën. A më kuptoni? Vetëm një! Ajo është imja (i afrohet dhe i hedh dorën në sup Shpresës).

NËNA — Im shoq vdiq në burg në vitin 1938 si komunist. Vdiq për një qëllim. Tani unë s'kam njeri tjetër përvèç Skënderit. Me të unë i ndaj hidhërimet dhe gjëzimet e mia. (afro-het te Skënderi).

ALFREDI — Prapë sikur dëgjohet zhurmë aero-planësh!

SHPRESA — Si ështëjeta! Unë mendoja që nesër në mëngjes të këpusja trandafila të kuq për Skënderin...

ALFREDI — (i pret fjalën Shpresës) Aeroplanët u kthyen. (Dëgjohet zhurma e tyre). A dëgjoni? u kthyen.

SKËNDERI — Po. U kthyen... Kështu, me zhurmë aeroplanësh e përshëndeti rininë tonë jeta.

T a b l o e d y t ë

Rrugë. Sa ka filluar mbrëmja. Aty pari kalon hijerëndë një patrullë karabinierësh. Pas pak edhe një tjetër. Pastaj duket Shpresa e mbështetur në një shtyllë elektrike. Asgjë s'dëgjohet përvèç zërit të një kukumjaçke.

SHPRESA — (Dëgjon zërin e kukumjaçkës). Ja edhe kukumjaçka! Ajo pas çdo shtegëtimi ndalet dhe këndon. Këndon këngën e saj të trishtuar. Por njerëzit nuk e kuptojnë se çfarë këndon ajo. (Pauzë). E mjera unë si më janë ngatërruar mendimet!

KOPSHTARI — (duke kaluar andej) Mirë mbrëma, Shpresa.

SHPRESA — (trembet) Oj, sa u tremba! Mirë mbrëma, xha Luftar.

KOPSHTARI — S'ke ardhur më andej. Kopshti është mbushur plot me trandafila të kuq.

SHPRESA — Nuk më ka rastisur, xha Luftar. Pastaj Skënderi është i zënë.

KOPSHTARI — Megjithatë, ndihmoje dhe ti ca dhe ejani.

SHPRESA — Ai tani s'ka shumë kohë. Ja, unë atë po pres, por...

KOPSHTARI — S'bën vëtëm të presësh, por edhe të shkosh. Dashuria s'duhet fshehur, apo jo?

SHPRESA — Keni të drejtë, xha Luftar, por ja që erdhën kohë të vështira dhe...

SKËNDERI — (**Eshtë i veshur me rroba mekaniku**).

Mirë mbrëma. Si jeni, xha Luftar? (e qafon) KOPSHTARI — Si pleqtë.

SKËNDERI — Si pleqtë, por me zemër të re.

KOPSHTARI — Dhe me shpirt të vrarë.

SKËNDERI — Po pse këshfu?

KOPSHTARI — (**dëgjon kukumjaçkën**) Sepse ngushullohemë duke dëgjuar këngën ogursëze të kukumjaçkës, ose duke soditur patrullat e karabinierëve që sillen lart e poshtë.

SKËNDERI — (**që e kupton ironinë**) Refren i përkohshëm, xha Luftar.

KOPSHTARI — Nejse, se e zgjata. Ku janë dy, i treti është i tepërt. (**përshëndetet me ta**) Mirë u pafshim.

SKËNDERI dhe SHPRESA — Mirë u pafshim, xha Luftar. (**Luftari del.**)

SKËNDERI — Sa plak i mirë dhe i dashur që është.

SHPRESA — Skendo! Unë kaq shumë kam pritur...

SKËNDERI — Më fal, Shpresa, po ashtu më ndodhi.

SHPRESA — (**dallon në rrobat e Skënderit një njo-**
llë të kuqe) Ç'është kjo njollë e kuqe, Skendo?

SKËNDERI — Asgjë, bojë.

SHPRESA — Skendo?!

SKËNDERI — Folë, Shpresa.

SHPRESA — (**hesht.**)

SKËNDERI — Pse më dukesh kaq e trishtuar?

SHPRESA — Nuk e di. Mendimet ngandonjëherë ma shtrëngojnë kokën kaq shumë sa...

SKËNDERI — (**me përkëdhelje**) Po përsë e mundon veten kot së koti, Shpresa?

35934

46896

SHPRESA — Mendoj lumturinë tonë.

SKËNDERI — E kush mund ta prekë lumturinë tonë?

SHPRESA — Jo, dua të them se ne e kemi në dorë ta bëjmë më të bukur se ç'është.

SKËNDERI — Dhe do ta bëjmë.

SHPRESA — Unë bisedova me babanë. Ai më tha se ka ndërhyrë që të na dërgojnë për studime në Itali. Kështu që, pas disa vjetësh, ti do të jesh muzikant i shquar, ndërsa unë mësuesë letërsie. Ç'mrekulli, a? Unë do të shkruaj vjersha për dashurinë, kurse ti do t'i kompozosh.

SKËNDERI — (duke i treguar njollën e kuqe) Shpresa! E shikon. Unë jäm gjakosur. Pak përpara në shtypshkronjë u rrahëm për vdekte me tre karabinierë që goditën një punëtor.

SHPRESA — U rrahët me karabinierët?!

SKËNDERI — Po, Shpresa. Andaj ne tani nuk duhet të largohemi nga Atdheu, A më kupton?

SHPRESA — Po, sikur ata t'ju qëllonin me armë?!

SKËNDERI — Edhe kjo mund të ndodhë.

SHPRESA — Sa e tmerrshme! Po ç'tu desh ty! Jo, Skendo, ne duhet të nisemi sa më parë.

SKËNDERI — Jo, Shpresa. Ne duhet të qëndrojmë këtu.

SHPRESA — Ne me çdo kusht duhet të nisemi.

SKËNDERI — Ne me çdo kusht duhet të qëndrojmë, Shpresa.

SHPRESA — Ja, Alfredi bëri mirë që shkoi për studime.

SKËNDERI — Por arma të tjerët po kthehen. Edhe Alfredi do të kthehet. Ndryshe s'ka se si të...

SHPRESA — Skendo! Po a nuk tē duket ty se
nē këtë mënyrë mund tē prishet lumturia jonë?

SKËNDERI — Ne do ta mbrojmë lumturinë tonë.
Dhe jo vetëm tonën, Shpresa.

SHPRESA — Tek e fundit unë interesohem pér
lumtérinë tonë personale. Të tjerët le tē
bëjnë çfarë tē duan.

SKËNDERI — (i habitur nga ky qëndrim) Këte
nuk e prisja, e dashur.

SHPRESA — Po, po. Ne duhet tē mendojmë më
shumë pér lumtérinë tonë, Skendo. Kurse
ti ke filluar tē zihesh me karabinierët.

SKËNDERI — Shpresa! Tē lutem shumë merri
prapë fjalët që the. Ato s'të përshtaten ty.
Në më do, thuaj se tjatër gjë deshe tē thuash.
Tē lutem shumë bëje këte. Bëje këte pér
hir tē dashurisë sonë.

SHPRESA — (e'ndjen se s'foli me takt). Po ç'të
keqe ka këtu, Skendo?

SKËNDERI — (i dëshpëruar). Ka, Shpresa, ka.
Lumtérinë s'duhet vetëm t'ja kërkojmë njeri-
tjetrit, por edhe t'ja japim shoku-shokut.
(Sirena e alarmit i ndërpërt fjalën Skënderit.)

SHPRESA — Alarm! Hajde tē shkojmë, Skendo.
(Shpresa del. Skënderi pér një moment mbe-
tet si i ngrirë dhe pas pak del andej nga
doli Shpresa. Ndërkohë nga ana e kundërtë
e skenës, duket prapë një patrullë karabini-
rësh. Sa largohet ajo, hapet tablloja III)

Tablo e tretë

Mëngjez, Në shtëpi tē Skënderit. Një dhomë
mobiluar me shumë shije e thjeshtësi. Nëna

po merret me punë shtëpie. Nga shkallët e
dhomës tjetër zurret Skënderi, i cili sapo është
zgjuar.

SKËNDERI — Mirë mëngjezi, nënë!

NËNA — Po ti pse nuk pushove edhe ca? Sot
është e dielë.

SKËNDERI — Të diela s'ka më. Të dielat u pri-
shën, nënë!

NËNA — U prishën të keqen nënë. Po eja të të
përqafoj.

SKËNDERI — Po përse gjithë kjo ceremoni?

NËNA — Si përse? Ti ke harruar fare. (e puth)
Sot ke ditëlindjen.

SKËNDERI — (e puth nënën.) Rrofsh, moj nënë,
rrofsh!

NËNA — Qofsh i lumtur, bir... Zoti të bekoftë.

SKËNDERI — Zoti! Jo, nënë. Nga zoti s'dua be-
kim. Bekimi tënd më mjafton.

NËNA — Ashtu qoftë. (Duke i dhënë një zarf.)
Na, merrë këtë letër. E solli Petriti.

SKËNDERI — Petriti? (Hap zarin).

NËNA — Po. Dhe më tha të marrësh me vete atë
plaçkën.

SKËNDERI — Mirë, nënë. (mbaron së lexuari dhe
fillon të preqatitet.)

NËNA — (pregatit mëngjezin.) Skendo! Shumë dja-
lë i mirë më duket ai Petriti.

SKËNDERI — Ashtu është, por i vetëm.

NËNA — Si i vetëm, s'ka njeri fare?

SKËNDERI — Një vëlla, që kish, i ra në Spanjë.

NËNA — Në Spanjë? (sikur ja thotë vetes.) I var-
féri shqiptar! As për lirinë e të tjerëve nuk
e ka kurzyer gjakun.

SKËNDERI — Nuk ë ka kurzyer, nënë. Ndaj sot

unë, Petriti e të tjerë jemi vendosur në një barikadë për të mbrojtur lirinë.

NËNA — (duke e shikuar të birin drejt në sy, dallon në fytyrën e tij lodhje e pagjumësi).

Sa i lodhur që dukesh! Je hequr fare, të keqen nëna. Tani ulu e ha një kafshatë bukë. Ja tek e ke gati. (Skënderi ulet, të hajë, kurse nëna merr të qepë, një këmishë).

SKËNDERI — Po ti, nënë, çfarë po qep ashtu?

NËNA — Një këmishë.

SKËNDERI — (duke shpejtar në të ngrënë.) Të kujt?

NËNA — Tënden! Dua të ta dhuroj për ditëlindje.

SKËNDERI — Nënë! Lëre atë këmishë... Qëndis më mirë një flamur. Flamuri është këmisha e revolucionit.

NËNA — (dëgjon e habitur) Biri im! Ngandonjëherë kur flet kështu... se si më duket! Sikur tmerrohem... sikur e ndjej veten, të vetëmuar, sikur më kap frika...

SKËNDERI — Frika, nënë! Po përsë?

NËNA — Skendo! Sa e tmerrshme! Ruaju, të keqen nëna. Armiku është i veshur me hekur. A nuk shikoni? Ruaju, të keqen nëna. Unë s'kam gjëzim tjetër përvëç teje.

SKËNDERI — Mos u merakos, nënë.

NËNA — Po të ftohet çaji.

SKËNDERI — Mbarova së ngrëni.

NËNA — Kaq shpejt?

SKËNDERI — Mbarova. Por do të lutem për diçka.

NËNA — (duke ngritur enët) Për çfarë?

SKËNDERI — (i tregon një shportë të mbushur me fruta.) Meqenë se unë kam një punë me rëndësi, dërgoje gjer te Luani këtë shpor-

të me fruta, sepse ma kanë lënë amanet.

NENA — Mirë. Ma jep shportën. (merr shportën)
U! Sa e rëndë qenka!

SKËNDERI — Më fal, nënë, po do ta shpërblej.

NENA — (duke u bërë gati.) Mirë, mirë. Kur të
dalësh, çelësin e portës lëre aty sipër...
Mirë u pafshim. (del.)

SKËNDERI — Mirë u pafshim!

NENA — (kthehet) Skendo! Mos u vono, të keqen
nëna. Merr me vete edhe Shpresën dhe haj-
deni një cikëz më shpejt. (del.)

SKËNDERI — Mirë, nënë... (me veteve) Kanë të
drejtë nënët e gjora. Duan t'i kenë pranë
fëmijët. Por edhe ne s'kemi faj. Për të
mbrojtur dashurinë e nënave luftojmë. (në
këtë kohë fillon të mbështjellë disa trakte.
Pas një pauze dëgjohen të trokiturat e por-
tës. Fsheh traktet dhe hap portën. Te porta
duket Shpresa, që mban në dorë librin
«Brengë dhe lot». Ajo është e hequr në fy-
tyrë. Të duket sikur e ka humbur freskinë
e dikurshme.)

SHPRESA — A mund të hyj?

SKËNDERI — (ftohë) Hajde!

SHPRESA — Mirë dita, Skendo!

SKËNDERI — Mirë dita.

SHPRESA — (Pas një pauze) Nënën nuk e paske
në shtëpi?

SKËNDERI — Vajti diku... Do të kthehet së
shpejti.

SHPRESA — Fort mirë... Po pse s'më fton të
ulem, Skendo! Kaq kohë që s'jemi parë!

SKËNDERI — Më fal. Ulu.

SHPRESA — (lë librin «Brengë e lot» mbi raft

dhe ulet; sheh kitarën të varur në mur.) Kitara qenka mbushur tërë pluhur.

SKËNDERI — Po. Ka kohë që s'i kam rënë...

Që kur m'u thye kukulla, s'i kam rënë më.

SHPRESA — (me pahir e përmban veten) Skendo!

Mua më ka zënë malli. Merre, të lutem, kitarën.

SKËNDERI — Nuk mundem. Gjishterinjtë e mi janë forcuar. Ata e kanë humbur aftësinë e tyre... Ata nuk mund të nxjerrin më tinguj të émbël pér kukullat. A më kuptoni! Nuk mundem.

SHPRESA — Bëje këtë të paktën pér dashurinë.

SKËNDERI — Nuk mundem. A më kuptoni?

SHPRESA — Të kuptoj, Skendo, të kuptoj... Por... (fshin lotët)

SKËNDERI — Mos më detyroni të fyej dashurinë.

SHPRESA — Dikur edhe unë mendoja kështu. Por jeta paska kaq të papritura...

SKËNDERI — Varet nga si ta kuptosh. Disa e ëndërrojnë jetën ngushtë në mes të luleve, kurse disa të tjera e shohin në mes të njërzve, në mes të flakëve.

SHPRESA — Ti paske ndryshuar fare, Skendo!...

SKËNDERI — Gjithashtu edhe ti.

SHPRESA — Unë ëndërroja të ishim së bashku, të krijonim familjen dhe të rronim të lumenj.

SKËNDERI — Të lumtur në mes të fatkeqësive dhe të gjunjëzuar para armikut? (nuk e përmban veten.) Pa hidhe pak vështrimin më tej nga praku i shtëpisë, dhe do të shikosh se si vuajnë njerëzit, ndërsa një pjesë pasurohet. Fashizmi po e bën shkrumë e hi At-

dheun, kurse disa e shikojnë këtë tablo sikur të shihnin ndonjë film zbavitës. Si është é mundur të durosh?

SHPRESA — Mjaft. (e papërmrbajtur.) Unë e thashë nga dashuria.

SKËNDERRI — Nga dashuria! Po të jetë kështu, atëhere pse nuk hidhesh në një barikadë me mua?

SHPRESA — Kam frikë... Kam frikë për ty, për veten time. Kam frikë për dashurinë, për babanë, për të gjithë kam' frikë.

SKËNDERRI — Po të tjerët çfarë janë, Shpresa? A mos mendon ti se ata nuk dashurojnë, se nuk kanë nëna, baballarë, osë shokë? Si mund të gjykosh në këtë mënyrë, Shpresa? Folë, unë të pyes... Në emër të dashurisë dua të më përgjigjesh.

SHPRESA — Mjaft. Mjaft të lutem... Unë nuk mundem. Unë e ndjej veten kaq të lodhur. (çohet.) Lamtumirë, Skendo!

SKËNDERRI — (e përcjell me keqardhje.) Lamtumirë, Shpresa... E pat dashuria jonë. (Dy pika loti i rrëshqasin ndër faje.) I fola rëndë...! Sa të forta i ka bërë lufta zemrat tonë!... Eh! Shpresa, Shpresa! Nejse! (merr traktet dhe pregetitet të dalë. Jashtë dëgjohen hapat e një kompanie ushtarësh që shoqërohen nga tingujt e një marshi. Pas pak hyn Alfredi.)

ALFREDI — Mirë që të gjeta, Skënder. Thashë se kishe shkuar.

SKËNDERRI — Për atje po nisem. Ti a je gati?

ALFREDI — Dëgjo, Skënder. Unë tamam për këtë çështje erdha.

SKËNDERI — Pse, si është puna? ALFREDI — (si me keqardhje.) Unë sonte nuk

mund të marr pjesë në djegjen e depos.

SKËNDERI — Gjynah! ALFREDI — Edhe mua më vjen keq, aq më shu-

më se e kam për herë të parë, por s'kam se ç'bëj. Më doli një punë e papritur famil-jare që s'e lë dot.

SKËNDERI — S'ka gjë. Mos u dëshpéro, Alfred.

ALFREDI — Jo, po më vjen inat.

SKËNDERI — (duke i rënë supit.) Do të kemi plot raste. Por hajde të shkojmë, se do të vono-hemi. (Dalin. Pastaj hyn nëna.)

NËNA — C'zagushi! Të zihet frymë. I tërë vendi sikur s'ngopet më frymë... C'kohë të vë-shtira që erdhën. Se si do të zgjidhet ky lëmsh, zoti e di! Por edhe ai është tërbuar dhe s'di se si të veprojë. (sheh mbi raft librin që ka lënë Shpresa dhe lexon me zë titullin.) «Brëngë e lot!» Po kjo çdo të thotë! (Trokët dëra dhe hyn Besniku. Ky është një fëmijë pak a shumë i rritur.) Hajde Besnik, i bleve?

BESNIKU — (mban në dorë një letër të mbësh-shtjellë.) Urdhëroni, zonja mësuëse. Brodha në të katër anët e qytetit dhe mezi i gjeta. Të gjitha kushtuan një napolon e gjysmë.

NËNA — Falemnderit, Besnik... Na, prit. (i jep një sheqerkë.) Merre për ditëlindjen e Skënderit.

BESNIKU — U bëftë njëqind vjet... Tani po iki se më presin shokët. Kemi punë.

NËNA — Po ç'punë ke ti? Ti je një fëmijë.

BESNIKU — Edhe ne fëmijët duam të bëjmë diçka për atdheun. Ditën e mirë. (del.)

NËNA — (me habi.) Edhe fëmijët duan të bëjnë diçka! (ulet dhe padashur sytë i venë në mur, ku është varur portreti i të shoqit.) E shikon, Agron? Ti kishe të drejtë kur thoshtje se do të vijë koha kur tek ne do të çohen i madh dhe i vogël. Veç ne nënënat jemi nëna e na dhëmb shpirti... Ja, sot Skendua ka ditëlindjen dhe nuk është në shtëpi... A e sheh, pra, se sa të vështirë e kam unë pa ty? (Gjatë kësaj kohe herë mbas here troket porta. Hyn brenda kopsh-tari me një thes të vogël në dorë. Nëna pas një pauze e merr veten dhe çohet.)

KOPSHTARI. — Mirë dita, mësuese.

NËNA — Mirë se erdhe, z. Luftar.

KOPSHTARI — S'të shoh shumë të gjuar. Paske rënë në të thella.

NËNA — Jo. Ashtu kot, se si më erdhni.

KOPSHTARI — Flaki, tej mendimet e shumta se të plakin para kohe. Ne duhet të rrojmö apo jo?

NËNA — Por ja që ngadonjëherë...

KOPSHTARI — Gjysma e mijës pesëqind. Nejse. Mësuese...!

NËNA — Po uluni, z. Zuluftar. Unë sot kam ditëlindjen e Skënderit.

KOPSHTARI — Po folë, moj mësuese. (ulet, nxjerr nga xhepi një llullë të punuar me dorë përmrekulli.) E kam punuar vetë. Le ta ketë Skënderi kujtim nga unë. Të na rrojë përgjëzimin dhe lumtërinë tënde dhe të gjithë ne të tjerëve.

NËNA — Të falemnderit shumë, z. Zuluftar.
(e qeras me raki.) Ç'gjë të bukur që keni
punuar! Paskeni duar të arta.

KOPSHTARI — Të arta i kam, por ç'e do kur s'më
kanë dhënë për të ngopur barkun. (ngre
gotën.) Hajde, me jetë të gjatë e gjëzime.
Me një nuse tani.

NËNA — Të bëftë mirë.

KOPSHTARI — (pi.) Që thoni ju, zonja mësuese,
këtë zanat e kam mësuar kur kam qenë
marinar. Atëhere, gjatë minutave të lira,
xheku punoja ndonjë gjë të vockël dhe e
shisja kur ndaleshim nëpër skela të ndry-
shme të botës. Pata gdhendur dikur një
violinist të verbër, duke i rënë violinës dhe
pranë tij të bijën — një bukuroshe të mi-
tur, që kërkonte lemoshë nga turma. Kjo
punë i bëri përshtypje të madhe një fran-
cezi, i cili më shpërbleu me 1000 franga. Ka
vlluar shampanja atë natë në anije që ç'ke
me të. Pinim dhe këndonim. Gëzimi derdhej
nga kupat! Shokët ngrinin dolli për shën-
detin tim si për shëndetin e ndonjë artisti të
madh! Po ky gjësim qe i shkurtër, mbasi, kur
u ktheva 'në atdhe, atë ma vranë.

NËNA — (që dëgjon me shumë interes tregimin)
Cilin?

KOPSHTARI — Gëzimin!

NËNA — Pse, si ndodhi?

KOPSHTARI — Ndodhi kështu: apo u ktheva 'në
atdhe, gdhenda me qejf të madh, si i thonë
fjalës, portretin e Avni Rustemit. Më dolli
një punë e mrekullueshme. Të gjithë mahni-
téshin kur e shikonin. Por një ditë prej di-

tësh më lajmëruan të marr me vete portretin dhe të paraqitem në xhandarmëri.

— Ti e ke bërë këtë fotografi — më thotë tërë inat një toger me mustaqet gjer te veshët dhe me zë të ngjirur.

— Po, i përgjigjем unë.

— Po pse, nuk gjete njeri tjetër të qesësh në fotografi? — shton dhe ma përplas portretin kokës, duke më nxjerrë me shkelma jashtë. Që prej asaj dite më zbuani nga puna dhe unë i hodha spirancat në kopsht. U bëra kopshtar. Merrem me rritjen e luleve. Ja, pra, zonjë mësues, ku më shpunë duart e mia të arta. E megjithatë unë pres që me këto duar të bëj diçka. Diçka të bukur që t'u pëlqejë njerëzve.

NËNA — (e habitur.) Sa keni vuajtur edhe ju z. Luftari.

KOPSHTARI — Se mos vetëm unë. E tërë bota vuani...

NËNA — Mbështetur do të bëhet më mirë.

KOPSHTARI — Prandaj luftojmë që të mos vdesin ëndërrat, dhe ëndërrave tonë armiqtë ua kanë frikën.

NËNA — Frika i ndjektë dhe u shofshin nga faqja e dheut.

KOPSHTARI — Ashtu do të ndodhë.

NËNA — (pas një pauze). Ne luftojmë... ata luftojnë...

KOPSHTARI — Veç me një ndryshim: ne luftojmë me flamur në duar, kurse ata me qefin nën sqetull. Apo s'është kështu?

(ngre gotën.) Gëzuar!

NËNA — Gjaku dhe mundi të mos vejë kot pa ...

KOPSHTARI — Ky popull tanipka zot, zonjë mësuese. Ndaj është hedhur në luftë i madhe i vogël. (pi.) Me të mirë. (Nëna rishtas i mbush gotën. Në këtë moment bie kongu i orës së murit.) Oua, ora vajti, kurse unë jam akoma këtu. Më mori mendtë rakia. Nuk thonë kot, mendtë s'ti merr Perëndia po rakia. (ngre gotën me fund dhe çohet.)

NËNA — Po rrini se tani vjen Skendua.

KOPSHTARI — Ai do të vonohet pak.

NËNA — Edhe sot?

KOPSHTARI — Mos u bëni merak. (nxjerr nga thesi disa letra dylli.) Këto jepja Skënderit dhe i thuaj se Patrioti u nis për në Bukrinë. Mirë?

NËNA — Po ky Patrioti kush është xhanëm?

KOPSHTARI — Një mekanik që punon së bashku me Skënderin. Por nejse, se m'u bë vonë. Natën e mirë. Vdekje Fashizmit!

NËNA — Dukuni, z.Luftar. (Nëna shtron tavolinën. Pas një copë here dëgjohet porta.) Urdhéroni, zoti doktor, urdhéroni.

DOKTORI — (duke hyrë.) Mirë mbrëma, zonja mësuese, dhe më falni se po ju shqetësoj në një orë të papërshtatshme.

NËNA — Ju lutem, doktor! Uluni!

DOKTORI — (ulet.) Bah, ç'zagushi! Të zihet fryma.

NËNA — Jashtë vetëtin.

DOKTORI — Me sa duket, do të bjerë shi.

NËNA — Le të bjerë, doktor. Bota ka nevojë të pastrohet. Kohët e fundit ajo sikur është ndyrë shumë. Apo jo? (servir piye.)

DOKTORI — Ju falemnderit, nuk pi.

NËNA — Sot kam ditëlindjen e djalit.

DOKTORI — Nuk pi.

NËNA — (pa ngulmuar). Po ku keni humbur, doktor? Na harruat fare.

DOKTORI — Ç'të bësh, zonjë, nuk na lënë të sëmurët. Përpinqemi t'ua mbyllim plagët, por ato prapë hapen.

NËNA — Kështu është. Plagët janë si portat. Mirë thonë: t'i vesh gishtin plagës, akoma s'do të thotë se pushoi gjaku.

DOKTORI — Por ka ca plagë që...

NËNA — Që nuk arnohen dot?

DOKTORI — Desha të them për plagët që...

NËNA — Edhe unë për atë e kam fjalën.. Për plagën e madhe që i është hapur Atdheut.

DOKTORI — Nuk më kuptuat. Fjalën e kam gjetkë. Dua të them.

NËNA — Ju dëgjoj.

DOKTORI — Zonjë e nderuar! Ç'bëhet kur të dhëmb shpirti?

NËNA — Ju jeni mjek dhe duhet ta dini më mirë nga unë.

DOKTORI — Këtu s'hyn mjekësia.

NËNA — Atëhere flisni më hapur. Plaga jote trupit të huaj s'i dhëmb.

DOKTORI — Shumë mirë e thatë. Ju jeni nënë dhe, si nënë, më kuptoni drejt. Askush më mirë se prindi dhe veçanërisht se nëna nuk e ndjen dashurinë për fëmijën. Apo nuk është kështu?

NËNA — Ashtu është. Im shoq, lavdi pastë, na tregonte se si njëherë, atëhere kur ai ishte i internuar dhe i detyruar të thyenë gurë i vetëmuar diku andej nga Peshkopja, e ëma

i dërgonte një letër, në të cilin i kish futur një cigare të pirë gati deri në fund dhe i shkruante: «Bir! Ja, si kjo cigare po më digjet shpirti dhe mbapse do të shuhem nga malli që më ka pushtuar për ty».

DOKTORI — Mjaft prekëse... Zemra e prindit e di se ç'heq. Ajo më solli këtu t'ju lutem për diçka.

NËNA — Flisni, doktor.

DOKTORI — E kam fjalën për Skënderin.

NËNA — (e frikësuar.) Mos i ka ndodhur gjë e ligë?

DOKTORI — Asgjë s'ka ndodhur; mos u shqetësoni.

NËNA — Flisni, doktor, si është puna.

DOKTORI — Fjalën e kam për marrëdhënjet e Skënderit me Shpresën.

NËNA — Çfarë ka ndodhur!

DOKTORI — Asgjë, asgjë. Vecse...

NËNA — Veçse çfarë?

DOKTORI — Si nënë që jeni do t'ju lutesha të ndikonit që ai... Më kuptioni... të heqë dorë nga vajza ime.

NËNA — (e habitur.) Doktor!

DOKTORI — Bëjeni këtë për hir të miqësisë sonë, për hatrin tim. Shpresa është vajza ime e vetme. Më kuptioni.

NËNA — Ju kuptoj!... Edhe unë Skënderin e kam djalë të vetëm.

DOKTORI — Më ndjeni, zonjë...

NËNA — Po ata prej kohësh e duan njeri-tjetrin, doktor.

DOKTORI — E duan, por... por Skënderi ka zgjedhur një rrugë të vështirë.

NËNA — E tillë është jetë.

DOKTORI — Kurse unë dua që ime bijë të jetë e lumtur, të gëzojë jetën.

NËNA — Po pse, vallë unë s'e kam këtë dëshirë!

DOKTORI — (i merr fjalët e nënës si gadishmëri...) Atëherë ndihmomëni.

NËNA — Që të ndahen?

DOKTORI — (Me mirësjellje.) Ju falemnderit që më kuptuat.

NËNA — ... Doktor! Ju e dini se dashuria s'duhet fyier, sepse, po të fyhet, sado pak, njeriut i hapen plagë në shpirt. Dhe plaga e shpirtit është shumë më e padurueshme se sa e trupit. Sa e tmerrshme është kur thonë: «Më dhëmb shpirti». Prandaj shpirti nuk duhet lënduar, nuk duhet fyier.

DOKTORI — (Me nervozizëm) Zonjë! Unë s'kam nevojë të më diktoni moral. Mua më është prishur qetësia familiare... Unë kam ardhur këtu përfatim e vajzës sime. Unë dua që të më lini të qetë, që yt bir të largohet prej saj.

NËNA — Doktor! Ju jeni mjek dhe mjeku ka në jetë një mision fisnik: ai e lehtëson njeriun nga dhëmbjet, kurse tani ju po bëni të kundërtën. E meqë kërkuat ndihmën time, si nënë që jam, ja ku po ju them: mës e fyeni dashurinë, lëreni atë të lirë, ndryshe...

DOKTORI — (çohet tërë inat.) Ju të gjithë... Por di unë se si ta zgjidh këtë çështje. (nis të dalë.)

NËNA — Doktor, harruat kapelën. (Doktori kthehet, merr kapelën dhe largohet tërë nervozizëm)... Jashtë bie shi. (Nëna rregullon ta-

volinën. Pas pak hyn Skënderi i lodhur po
i gëzuar.)

SKËNDERI — Mirë mbrëma, nënë.

NËNA — (e dëshpëruar.) Unë t'u luta që sonte,
të paktën, të vije më shpejt.

SKËNDERI — (e puth.) Më fal, nënokja ime. Hërë
të tjera do të jem më i rregullt.

NËNA — Po Shpresa pse s'erdhi?

SKËNDERI — Nuk e gjeta në shtëpi. Kishte vaj-
tur te një shoqe e saj.

NËNA — Mirë, mirë. Ulu të hamë.

SKËNDERI — (bëhet gati dhe shtrohet në tavolinë.) Hë, nënë. Çdo të më thuash ende pér
ditëlindjen?

NËNA — (duke ngritur dollinë.) Të jesh gjithmonë
kështu i mirë... Të uroj shëndet e lumtëri.

SKËNDERI — Urim më të mirë s'ka... Pér shën-
detin tënd, nënë, dhe të gjithë nënave të
tjera që na sollën në jetë. (e puth.)

NËNA — (i jep llullën e z. Luftar). Këtë ta dhu-
ron z. Luftar.

SKËNDERI — C'gjë e bukur! Po ato plackat i
solli?

NËNA — Ja ku janë atje. (Skënderi çohet t'i shohë.)

SKËNDERI — Sa plak energjik që është.

NËNA — Hë se pér pak harrova. Ai më tha se ai
shoku yt... si i thonë... Patrioti, u nis pér
në Bukrinë.

SKËNDERI — Ashtu? (me vete) Domethënë u nis.

NËNA — ...Shpresa ka kohë që s'ka ardhur.

SKËNDERI — S'ka ardhur, por...

NËNA — ... Kitara është bërë tërë pluhur. Ti ke
kohë që s'i ke rënë.

SKËNDERI — Nuk më ka qëlluar.

NËNA — Merre një herë e na luaj gjëkafshë.

SKËNDERI — Lëre, nënë. Më mirë të bisedojmë.

NËNA — (e merr kitarën dhe ja jep Skënderit.)

Merrja një herë si qëmoti.

SKËNDERI — Po çfarë t'i bie?

NËNA — Një këngë të bukur që të na qetësojë shpirtin. Ja, merrja, p.sh., asaj këngës së kukullave.

SKËNDERI — Kënga e kukullave është për kulla. Kurse ne na duhen këngë që të shpien drejt fitores. Ja, si kjo:

U ngritëm në bijtë e mjerimit,
Më ëndërra e revoltë në gji,
shpalosëm flamujt e qirimit,
Mbi vdekjen u sulëm për jetë liri.
Vëllezër, mbi ne përplasen tallazet,
Po varka drejt bregut lundron,
Tallazet shkumëzohen nga kënga
E kënga si stuhia n'fitore na çon.

NËNA — Bukur, fort bukur. (Në këtë moment shpërthen një plasje e tmerrshme. Flakët duken nga penxheret. Nëna tmerrrohet dhe shtrëngohet tek i biri.) Ç'është kjo plasje kaq e tmerrshme, Skendo?

SKËNDERI — Mos u frikëso, nënë. Kjo është vepra jote e parë për luftën tonë. Shporta me fruta që dërgova sot te Luani kishte mina. Me ato ne sot minuam një depo municioni të fashistëve. Shikoje këtë zjarr të madh. Është vepra jote.

NËNA — Biri im. Sa e tmerrshme! (shtrëngohet fort te Skënderi)

— Bie perdja —

PJESA E DYTE

Tablo IV

Pas ca kohe. Mbledhje në shtëpi. të Skënderit. Dalëngadalë po agon. Kur hapet perdja, menjëherë të krijohet përshtypja se të pranishmit, fytyrat e të cilëve ndriçohen nga një fener, janë mbledhur prej disa orësh. Ata kanë diskutuar me zjarr.

SKËNDERI — ... (flet me pasion dhe frymëzim.)

Kështu, pra, shokë, detyrat janë të qarta për gjithsecilin; ato janë të vështira, por të realizueshme për ne që luftojmë në prapavijat e okupatorit. Armiku duhet ta ndjejë veten orë e çast nën goditjet tonë. Kjo është porosia e Partisë: Ajo na këshillon se, që të fitojë lufta jonë, duhet të gjakosim duart. Ndryshe armiku na i pret ato dhe revolucioni dështon. (Të gjithë dëgjojnë me interes të madh.)

KOPSHTARI — Të lumtë goja, Skënder. Mirë e the. Fort mirë bile... Ne nuk harrojmë atë ditë, kur nazistët shtypën me tanks shokët tanë më të shtrenjtë: Flamurin, Shpendin, Sokolin, Margaritën dhe Lalin e vockël. Prandaj armikun nuk duhet ta përkëdhelim, siç

mendon ndokush, por i duhet shpuar koka me plumbë që të ndjejë mirë zëmërimin e grushtit të proletariatit. Apo nuk është kështu, more shokë... dhe ju shoqe?

TË GJITHË — Ke të drejtë, xha Luftar.

PETRITI — Në luftën tonë duhet të përdorim urrejtjen e masave, gadishmërinë e tyre për të bërë shkrumb e hi zaptuesin.

KOPSHTARI — (Çohet.) A e dini se çfarë më panë syt sot, ose, më mirë, dje, para se të vija në këtë mbledhje?

TË GJITHË — Flisni, xha Luftar.

KOPSHTARI — Disa fëmijë, me Besnikun tonë në krye, kishin zënë një qen. Në të dy anët qenit i kishin shkrojtur me gërqele: Hitler kaput. Gjithashtu i kishin vënë në kokë një helmetë, ndërsa në bisht i kishin lidhur dy kuti sardelesh dhe me vrapi e ndiqnin nga pas. (Të qeshura.)

AJO — Ç'fëmijë të zgjuar!

KOPSHTARI — Që thoni ju, qeni me të lehura vajti e u fut drejt në komandaturën gjermane, që është këtu afér spitalit...

AI — Përse, që të zinte vëndin e Hitlerit? (Të qeshura). Më fal, xha Luftar, Pastaj?

KOPSHTARI — Pastaj, shokë, ndodhi ajo që ndodhi. Qenin e zbojnë me shqelme dy gjermanë...

AI — Si të pa pregetitur për në partinë naziste. (Të qeshura.)

KOPSHTARI — Por aty shpejt doli një SS, i cili, pasi qëlloi me mashinkë qenin, e drejtoi zjarrin nga fëmijët...

AJO — (e trishtuar.) Vranë kënd?

KOPSHTARI — (me dhëmbshuri të thellë.) Po
Djalin e vetëm të një marangozi.

AJÓ — I shoftë Perëndia.

PETRITI — Ne vetë do të hakmerremi... Do të hakmerremi pér gjithshka; do të hakmerremi edhe pér djalin e vetëm të marangozit dhe nuk do të lejojmë më kurrë që nazistët të bëjnë koleksione me kokat dhe duart e fëmijëve tanë. (Pauzë.) Shokë, dëshëron të flasë njeri? (Heshtje.) S'ka? Atëhere me kaq mbledhja mbylllet...

DJALOSHI ME KASKETË — (energjikisht.) Kam një propozim.

PETRITI — Folë.

DJALOSHI ME KASKETË — T'ja marrim një, hërrë ashtu lehtë, shokë, këngës: «U ngritëm ne bijtë e mjerimit». Skendo! Merre kitarën. (Të gjithë këndojnë lehtë, por me afsh djaloshar. Drita fillon të agojë.)

PETRITI — Po agon, shokë. Duhet të shpërnda hemi. (Një nga një largohen të gjithë. Mbeten vetëm Skënderi me Petritin.)

SKËNDERI — Petrit! Siç të thashë edhe mbrëmë, çështja e Alfredit më shqetëson shumë. Ai kohët e fundit është hedhur fare në pasivitet. Mendimet i shpreh të paqarta dhe më duket si i frikësuar. — Në mbledhje s'vij dot,— më tha — se e ndjej veten keq.

PETRITI — Mos ka ndonjë hall familjar?

SKËNDERI — Po të ishte kështu, do të ma kish thënë, në një farë mënyre. Pastaj, unë e kam pyetur pér këtë, por asgjë!

PETRITI — Po a kë vënë re se me kë shoqërohet?
SKËNDERI — Xha Luftari më tha se e kish ta-

kuar një natë në birrarinë «Vëllazërimi», duke pirë me një farë Simon Leka, që sapo ish liruar nga burgu i Tetovës... Jam interesuar ta hetoj se kush është ky njeri, por akoma ky person për mua mbetet enigmë.
(Bisedën e ndërpret nëna.)

NËNA — (duke hyrë) Po bini e merrni një sy gjumë, more djemtë e nënës, se zbardhi dita.

SKËNDERI — (shuan fenerin.) Ne nuk na flihet, nënë. Ti shko shtriu.

NËNA — Tërë natën keni punuar... Nuk është mirë për shëndetin. Pushoni ca.

SKËNDERI — Nënë! Revolucioni nuk duhet të pushojë kurrë.

NËNA — Mirë, more bir, mirë. Por edhe ju duhet të çlodheni ca.

PETRITI — Ne e ndjejmë veten, fare mirë, nënë.

SKËNDERI — Ti shko çlodhu... Edhe ne tanimbarojmë.

NËNA — Mirë, mirë. Unë për ju e kam. (del).

PETRITI — Eh, nënët e gjora! Sa të mira janë! Lum ti, Skendo, që ke nënë. Nëna është gjithshka. Pa nënët bota do të ishte si pa diellin... Nejse, ku e lamë fjalën. Hë, tek ai personi. Njerëz të tillë të dyshimtë kanë filloar të duken aty-këtu. Këta janë më të dëmshëm se armiku i veshur me uniformë. Atë e ke ballë për ballë dhe mund ta qëllosh. Por ky që e fsheh kokën si breshkë është më i rrezikshëm. Nazistët po i përdorin shumë këta elementë. Duhet pasur kujdes.

SKËNDERI — Kjo më mundon. Andaj sot kam vendosur të bisedoj shtruar me Alfradin. (Dëgjohet gongu i orës së murit.) Vajti ora.

Unë tani po shkoj se kam takim me shokun Petrit, kurse ti shtriu ca. (vesh xhaketën.) PETRITI — Jo, edhe mua më duhet të shkoj deri te Adriatiku për të marrë ca materiale. Por më përpëra...

SKËNDERI — Hë, po. Ti nesër do të nisesh. Për pak më doli nga mendja. Të lutem shumë, Petrit, i thuaj Arbenit se këto ditë, sa po të ma sjellin, do t'ja nis atë fotografinë.

PETRITI — Ç'fotografi është ajo?

SKËNDERI — Një fotografi, ku kemi dalë së bashku me Arbenin në vitin 1942, pasi kryem aksionin e parë, kur vramë atë qenin...

PETRITI — Cilin?

SKËNDERI — He, more, atë majorin fashist. Vivenți Ranjin.

PETRITI — Po, po. Më kujtohet.

SKËNDERI — Veç të lutem, Petrit, mos harro se më ka shkruar disa herë. Dalim tani?

PETRITI — Dalim, por desha të të them diçka.

SKËNDERI — (i interesuar.) Folë, përse e ke fjalën?

PETRITI — Për Shpresën.

SKËNDERI — Ouu! Ajo punë ka marrë fund.

PETRITI — Jo, nuk është ashtu si...

SKËNDERI — Mos ma zerë në gojë, të lutem. Ç'ish për t'u bërë u bë.

PETRITI — (me urtësi.) Skendo! Ti s'ke të drejtë.

SKËNDERI — Si s'paskam të drejtë?!

PETRITI — Të sillesh në këtë mënyrë! Ajo...

SKËNDERI — (që ka humbur durimin.) Të lutem, Petritl... Tek e fundit, kjo është çështje personale!

PETRITI — Prit, mos merr zjarr!

SKËNDERI — (me pérçmim.) Po, po, personale.
Kështu si të them unë.

PETRITI — (nuk përbahet.) Por ama ne, tani,
nuk i përkasim vetëm vetes sonë. Pastaj
Shpresa...

SKËNDERI — Ç'më flet, Petrit. Sikur nuk e di
ti...

PETRITI — Dëgjomë mua një herë...

SKËNDERI — S'kam ç'të dëgjoj! Zemra është si
qelqi: po të ra nga dora thyhet.

PETRITI — Aty ta kam, Skendo! Mos e lërë të
bjerë. Shpresa është jona, jotja. Ajo në fillim,
si disa të tjera, u frikësua, por tani...

SKËNDERI — Nuk është e mundur!

PETRITI — Ki pakëz durim!

SKËNDERI — Po të ishte kështu, mbrëmë atë do
ta kishim pasur në mes nesh.

PETRITI — A e di ti se, pasi ka ikur nga burgu,
shoku Shpend, është shëruar në shtëpinë e
tyre?

SKËNDERI — Gjepura!

PETRITI — Po, po. Kështu është. Gjynah që e
morëm vesh kaq vonë.

SKËNDERI — Petrit!

PETRITI — Ajo ka ndikuar te doktori. Ata të dy
kanë bërë një shërbim të madh, Skendo! Na
shpëtuan një shok.

SKËNDERI — (i habitur.) Kjo më duket e pabe-
sueshme!

PETRITI — Por fatmirësisht e vërtetë. Për këte
më foli vetë shoku Shpend, në Bukrinë, pak
përpara se të nisësha për këtu. Pastaj unë
ja tregova historinë...

SKËNDERI — (mjaft i gjëzuar dhe i habitur.) Pet-

rit! (e puth.) Për fjalë të nderit, unë do të çmendem! Do të çmendem, të them. (i hidhet në qafë)

NËNA — (duke hyrë, e sheh këtë skenë.) Hej rini, rini!

SKËNDERI — Nënë! (e qafon dhe e vërtit.)

NËNA — Mos, mos se më merren mendtë. (pasi ulet në kolltuk.) Për pak m'i theve brinjët, mor i uruar!

SKËNDERI — Kam vendosur të çmendem, nënë!

NËNA — (Petritit.) Po ky ç'pat kështu? Papritur e pakujtuar!

PETRJTI — I ka hypur! Ç't'i bësh!

SKËNDERI — Po, po, vendosa. Hajde të dalim, Petrit. (e puth nënën)

NËNA — Po ç'ka ndodhur, bijt' e mi?!

PETRITI — Do ta merrni vesh, nënë. Ditën e mirë. (dalin.)

NËNA — Mirë ardhshi. (e buzëqeshur.) Rini! (çohet të kërkojë librin.) Oj sa më dhëmbin brinjët. (kérkon librin.) Ku ta kem lënë atë libër. (kérkon dhe gjen librin «Brengë dhe lot», lexon.) «Brengë dhe lot». Prapë ky i flamosur. Po ç'djall të solli këtu? (e hedh tej dhe vazhdon të kërkojë.)

BESNIKU — Mësuese! Erdha unë.

NËNA — Ja, këtu i ke gati. (i jep një thes të vockël.) Ndërsa romanin «Nëna» i thuaj Dritës se ja shpie vetë.

BESNIKU — Mirë. Vdekje Fashizmit! (del.)

NËNA — Liri Popullit! (fillon të rregullojë dhomën.)

KOPSHTARI — (duke hyrë.) Mirë dita, dhe Vdekje Fashizmit zonja, shoqja mësuese.

NËNA — Hajde Luftar. Uluni.
KOPSHTARI — Skënderi doli?

NËNA — Po.

KOPSHTARI — Po ti, moj e uruar, mbete duke pastruar shtëpinë.

NËNA — C'të bësh. Punët e shtëpisë s'kanë të mbaruar. Po ulu, de... Nga ishe kështu?

KOPSHTARI — Nissa me një fshatar për në shtab të brigadës disa materiale, si dhe flamujt që ke qëndisur ti.

NËNA — I shkathët je, zoti, pthu, shoku Luftar!

KOPSHTARI — Desha të veja edhe vetë dhe të mos kthehesha më kësaj radhe, por meazzallah, i mbushet mendja Skëndos? «Pse të gjithë partizanë do të vemi? Po këtu në qytet kush do të luftojë ballistik?» — thotë...

NËNA — Mirë thotë. (merr xhezven e kafesë.)

KOPSHTARI — Nejse, ndëgjo mësuese. Unë kafe s'dua. Më jep më mirë një raki të ngroh pakëz stomakun, se s'kam kohë të rri.

NËNA — E ku do të vesh tani? (i mbush gotën.)

KOPSHTARI — Unë erdha për një punë të vokël, personale, si të thuash.

NËNA — Për çfarë?

KOPSHTARI — (ngre gotën.) Që thua ti, mësuese, unë kam vendosur të martohem.

NËNA — Si?

KOPSHTARI — Po, po. Mos u çudit. Kam vendosur të martohem. Por, hëpërhë, mos i thuaj gjë Skëndos, se këta të rinjtë t'i venë teneqetë pas.

NËNA — Léri shakatë, Luftar.

KOPSHTARI — Jo, e kam me tërë mend... Pse? Përderisa e tërë bota martohet, edhe unë

dua të martohem. Pse, s'kam unë të drejtë
të martohem?

NËNA — Mirë xhanëm, mirë...

KOPSHTARI — Kam gjetur një nuse të mirë. Pak
si të kaluar nga mosha, por të mirë. T'i kë-
pusësh kokën... Ti bile mund ta njohësh.
Eshtë ajo italianka; ajo, moj, që ju çmend
i shoqi ditën e 28 Nëndorit nga frika se mos
demostruesit do t'i futeshin në shtëpi e ta
vrisnin... E mirë është, ë? Për t'i marrë
kokën. (ngre gotën.) Hajd, gëzuar.

NËNA — (që s'di se çfarë qëndrimi të mbajë)...
Po tani, Luftar, sikur s'është koha... dhe...

KOPSHTARI — (e kupton se e tepëroi.) Jo, moj më-
suese, se bëj shaka. Vate martesa jonë. Unë
jam martuar një herë. Nusja ime është Lufta
nacional-çlirimtare.

NËNA — Kurse mua më ngriu gjaku. Thashë...
Edhe këto shakatë tuaja, Luftar...

KOPSHTARI — Janë pa kripë do të thuash... Haj-
de t'i pastrojmë me raki. (ngre gotën.) Gë-
zuar, mësuese.

NËNA — Të bëftë mirë.

KOPSHTARI — (nxjerr një copë basmë të mbësh-
tjellë me kartë.) Kam blerë këtë copë, më-
suese. Do të të lutesha të ma bësh një këmi-
shë të mirë.

NËNA — (duke parë copën.) Ti ë din, Luftar, se
unë prej kohësh riuk qep më këmishë. Po-
thuajse kam harruar. Por ty do të ta qep.

KOPSHTARI — Ashtu të lumtë. Masën ti e di.
Nr. 40 (çohet.) Bëje pak si shpejt, mësuese,
se pa këmishë s'i dal dot përpara asaj ita-
liankës. (Qeshin.) Tani shkova. Ditën e mirë.

(del.) (Mësuesja vazhdon të rregullojë dhomën.) (Pas pak hyn Shpresa.)

SHPRESA — (duke hyrë.) Mësuese!

NËNA — (e habitur.) Shpresa?! Apo më bëjnë sytë!

SHPRESA — Unë, mësuese, unë.

NËNA — (e mallëngjyer) Sa mirë bëre! Po ulu, de. (Shpresa ulet.) Si je më shëndet, moj bijë? A të dhëmb më koka?

SHPRESA — Jo. Tani e ndjej veten më mirë.

NËNA — Po babai si është?

SHPRESA — Është ca i lodhur, por syzet i ka hequr fare. Thotë se «tani shoh më mirë pa syza».

NËNA — (duke marrë diçka për të qerasur Shpresa.) Kaq të kam pritur!

SHPRESA — (që ka përqëndruar vështrimin te kitara) Si thatë?

NËNA — Thashië se më mori malli. U bë kaq kohë. (e qeras.)

SHPRESA — Skendua si gjithmonë s'është në shtëpi.

NËNA — Ai ka shumë punë.

SHPRESA — Lufton.

NËNA — Kështu erdhën kohët. Të gjithë luftojnë.

SHPRESA — Të gjithë... veç ai qëndron në ballë. Në ballë është më vështirë.

NËNA — Puna është të mos mbetesh prapa.

SHPRESA — Kështu thotë edhe babai. Por në ballë, kjo është ç'është! «Nuk mjafton vetëm të urresh armikun, por dhe ta asgjësosh».

NËNA — Shpresa, ti...!

SHPRESA — Këto janë fjalët e Shpendit, të një komunisti që babai ja shkëputi nga duart vdekjes.

NËNA — Doktori?

SHPRESA — Po. Tani babai mbahet nën vrejtje.

Ai pas çdo tri orësh është i detyruar të parraqitet në Gestapo. (Në këtë moment, duke lebetitur, hyn në skenë Besniku.)

BESNIKU — Mësuese! Mësuese! Ku është Skënderi! Dua një bombë!

NËNA — Ç'është, ç'ke, të keqen nëna?

BESNIKU — Gjermanët dhe ballistët më vranë babanë!

NËNA — Babanë!

SHPRESA — Babanë!

NËNA — O Zot, ku i ke sytë? A nuk sheh se ç'bëhet?! (me sy të përlotur përkëdhel Besnikun.) Bëju burrë, të keqen nëna... Partizanët do të marrin hak për babanë tënd... Hesht të keqen nëna. Armiqtë i bëjnë gjithë të zezat, prandaj janë armiq. (me pâthos.) Por jo. Ne nuk do të lejojmë. Nuk do të lejojmë më kurrë të shuhet gazi i fëmijëve, shpresat e tyre. (Dëgjohen këmbanat e kishës së qytetit).

BESNIKU — A dëgjon, mësuese? Po bien këmbanat. Pas pak babanë do ta përcjellin. (papritur thërret:) Dua një bombë... Dua një bombë! Dua të hakmerrem! (del me vrap. Tingujt e kambanave shtohen.)

NËNA — Besnik! Besnik! Ku vete, Besnik! Prit! (i vihet pas. Shpresa mbetet në skenë, si e shushatur.)

SHPRESA — Sa e llahtarshme! (Kambanat bien më fort.) Po, Shpend! «Nuk mjafton vetëm të urresh armikun, por dhe ta asgjësosh»... Kjo është rruga! (del. Pas një pauze, në skenë hyn Skënderi dhe Alfredi.)

SKENDERI — Ç'sinfoni e trishtuar kjo e kambaneave të qytetit tonë!

ALFREDI — Dhe sa fort që bien...! Kush të ketë vdekur vallë?

SKENDERI — Një njeri!. . Kambanat lajmërojnë vdekjen e njerezve. Ne do t'i bëjmë ato që paskëtaj të lajmërojnë fitoret e tyre.

ALFREDI — (sikur flet me vete.) Sa vështirë që është!

SKENDERI — Vështirë! T'i thuash ndal vdekjes është vështirë. Por jo e pamundur... Ulu, Alfred. (i jep cigare dhe, mbasi ja ndez, i mbush një gotë. Alfredi i mendueshëm ka tretur vështrimin diku.) Ç'mendon ashtu, Alfred?

ALFREDI — Asgjë. Po shoh kitarën... Se si m'u kujtuan ato ditë plot këngë që kalonim dikur... Ti me Shpresën dhe... ,

SKENDERI — Ato ditë vanë e shkuan. Të tjera erdhën.

ALFREDI — Ashtu është. Vanë e shkuan.. Tani më për dashurinë s'këndojmë dot, tani... .

SKENDERI — Përkundrazi. Mu si sot më kujtohen fjalët e shokut Petrit, që tha në një takim: «Ne kemi nevojë t'i, këndojmë jo vetëm luftës sonë, por edhe dashurisë. Me dashurinë tonë të fortë ne do ta mposhtim armikun».

ALFREDI — Po kur është i madh armiku?

SKENDERI — Atëhere këngët duhet të jenë më të fuqishme. Kënga është si flamuri. Ajo të prin. Kjo të shpie përpëra. Dhe kur ate e këndojnë revolucionarët, ajo pret më shumë se shpata, rreh më larg se plumbi.

ALFREDI — Më pëlqen optimizmi yt. Por zjarri me kartë nuk mbështillet.

SKËNDERRI — Alfred! Le t'i hapim letrat... Ti më duket se kohët e fundit je stepur... ku e ke hallin? Çfarë të mundon?

ALFREDI — E ardhmja e Atdheut... A nuk të duket ty se ne kohët e fundit nuk po veprojmë si revolucionarë, por si rebelë.

SKËNDERRI — Si rebelë! Ne si rebelë! Nga ç'pikëpamje?

ALFREDI — Nga pikëpamja e qëndrimit tonë ndaj masave patriotike... Ndaj ballistëve, për shembull.

SKËNDERRI — Folë, folë!

ALFREDI — Ne në vend që t'i afrojmë ata, dhe t'i nxism për luftë të përbashkët kundër të njejtët armik, i luftojmë ata si armiq dhe shkakëtojmë kështu vëllavrasjen. Gjak-derdhje...

SKËNDERRI — Dhe këte e thua ti! Po sa e sa herë Partia u ka bërë thirrje këtyre qelbësirave, që të kthehen në rrugë të drejtë, revolucionare? Kurse ata zgjodhën, si më të mirë, rrugën e tradhëtisë, rrugën e bashkëpunimit me armikun... A nuk më thua: kush djeg e vret popullin, ne apo ata? Kush u derdh plumbi të shkrirë në gojë komunistëve dhe patriotëve tanë që dergjen ndër burgje e kampe përqëndrimi, ne apo ata!... Folë, pse hesht?

ALFREDI — Po ti prit të shpjegohem. Pse inatosesh.

SKËNDERRI — Si të mos inatosem, kur ti luftën dhe hakmarrjen tonë e quan rrebelizëm? Si

të mos inatosem kur ti na këshillon të bashkëpunojmë me armikun? Kjo është gjuha e oportunistëve, e tradhëtarëve, Alfred! Përtatë, ti e di fare mirë, në kemi vetëm një përgjigje — plumbin ballit.

ALFREDI — Kjo s'është e vëtmja rrugë.

SKËNDERI — Tjetër rrugë lufta jonë nuk njeh.

ALFREDI — Ky qëndrim i ka trëmbur një pjesë të intelektualëve të ndershëm.

SKËNDERI — Frikacakët po... Por ata janë pakica. Tek e fundit, ne jemi me popullin.

ALFREDI — Mirépo populli është i paditur, analafabet. Nesër kur të çlirohet Shqipëria, këtë popull inteligjenca do ta udhëheqë në ndërtimin e Atdheut, që është bërë shkrumb e hi.

SKËNDERI — Sa pak e njeh popullin tonë... Ky popull po bën revolucion. Dhe një popull që bën revolucion, është i aftë për gjithshka.

ALFREDI — Kjo i përket së ardhmes.

SKËNDERI — Edhe ne revolucionin nuk e bëjmë për të fituar të drejtën e një frymëmarrjeje sot, por për të sigruar të ardhmen e lumenit nesër.

ALFREDI — Për ç'lumtëri po flasim, kur ne me veprimet tona i nxisim gjermanët që për çdo ditë të na djegin, t'i shtojnë masakrat e tyre e të mos na lënë asgjë veg eshtra, kufoma dhe gërmadha?

SKËNDERI — Të kuptoj!... Tani e kam fare të quartë... Sipas mendimit tuaj, ne duhet të rrimë duar kryq.

ALFREDI — Jo, por të mos i egërsojmë ata.

SKËNDERI — Dhe të presim që nazistët të largohen vetë dhe këto luftorë, që nuk ha të

lëna, të na i dorëzojnë nesër, më ceremoni. Kësaj i thonë kërcën prifti nga belaja... (me nervozizëm). Kush t'i ka futur në kokë këto mendime? (e mbërthen për fytin.) Ti tani do të m'i thuash të gjitha, një nga një. Të gjitha këtu pa luajtur nga vendi.

ALFREDI — (me sy të zgurdulluar.) Skënder! Ç'bën kështu? U marrose?

SKËNDERRI — Ose do m'i thuash sot të gjitha, ose përndryshe...

ALFREDI — Lëshoma, Skendo, lëshoma. Unë...

SKËNDERRI — Folë të them, se ta mora shpirtin.

(Hyn nëna.)

NËNA — Ç'bëni kështu? Skendo, lëshoje.

SKËNDERRI — (e përplas në divan.) Qelbësirë!

NËNA — Po ju sikur të jeni armiq e jo shokë!

ALFREDI — Ne po bisedojmë, kurse ai...

SKËNDERRI — (tërë inat) Falëndero nënën, pa përndryshe...

NËNA — (autoritare.) Skendo!

ALFREDI — E shikon si hidhet? S'të le as të arësyetosh.

SKËNDERRI — C'farë arësyë kërkoni ti, mor...

NËNA — Pushoni! Turp të keni! Turn! Tani kur ne duhet të jemi më të dashur e të lidhur me njeri-tjetrin, ju grindeni sikur...

ALFREDI — Por unë...

SKËNDERRI — Nënë! Ti nuk...

NËNA — Heshthni... (Pauzë.) Pak përparrë përcuallëm rër në banesën, fundit babanë e Besnikut.

SKËNDERRI — Vdiq!

NËNA — Jo, Jo. E vranë. Gjermanët dhe ballistët e vranë.

SKËNDERI — (Alfredit.) A dëgjon ti? Gjermanët
dhe ballistët e vranë.

ALFREDI — Më fal, mësuese. (cohet.)

SKËNDERI — Jo, rri. Rri të mësosh mbi veprat
e gjermanëve dhe ballistëve.

ALFREDI — Unë po largohem. (del.)

SKËNDERI — Prapa diellit të vesh.

NËNA — Asgjë s'kupto! C'ka ndodhur midis jush?

SKËNDERI — Ai, nënë, ka tradhëtar, me sa
duket.

NËNA — Ka tradhëtar!? (Trokët dera.) Dikush
është. (shkon të hapë derën.) Hajde, Shpresa,
hajde! (Skënderi mbetet si i shtangur.)

SHPRESA — Mirë mbrëma, nënë! Mirë mbrëma.
Skendo!

NËNA — Sa mirë bëre që erdhe! (e qafon.)

SHPRESA — Unë erdha, nënë... Skendo! Unë
vendosa... Unë s'mund të jetoj pa ty. Unë
nuk kthehem më. Unë.. erdha për gjith-
monë.

SKËNDERI — Me të vërtetë?

SHPRESA — Po, Skëndo!

SKËNDERI — (nuk e zë vendi.) Shpresa...! Nënë!
Shpresa ka ardhur për gjithmonë... Ajo nuk
kthehet më. A e kupton ti ç'do. të thotë të
mos kthehes?

NËNA — (mjaft e gjuar.) Mirë, mirë e kupto!...
Hajde de, q'më rrini kështu si mumje. Për-
qafohuni... (i merr për dore.) Hajde, mos
u turpëroni. (Ata qafohen.) Qofshi të lumtur.
Kështu erdhën kohët, dashuri e luftës. (Dë-
gjohet motivi i sonatës së Betovenit).

SKËNDERI — Po... Dashuri e luftës? Por pas

kësaj lufte është fshehur lumtëria jonë...
Shpresa! A e shikon ti lumtërinë?

SHPRESA — E shoh, Skëndo, e shoh. Ja tek është, atje në mes flakësh e veshur me fustan të bardhë nusërie.

SKËNDERI — Ajo na pret, Shpresa.

— Bie perdja —

Tablo e pestë

Në Gestapo, Zyra e kolonelit Otto. Ajo komunikon nga e djathhta me dhomën e torturave dhe nga e majta me sallonin. Në mur, përveç portretit të Hitlerit, pak më poshtë, është varur një automatik, një helmetë dhe një kitarë. Roberti (një rreshtë i ri nga mosha), lexon letrën që ka preqatitur për të emën).

ROBERTI — ...Ka një muaj që na sollën këtu nga fronti rus një shef të ri, berlinez, Otto quhet. Thonë se, kur ka qenë në Ukrainë, ka pushkatuar me dorën e tij vetëm çifutë më tepër se njëqind. Kur erdhi këtu në Shqipëri, ka shpikur metoda të reja çfarosjeje: Të burgosurit e dobët fizikisht i detyron të thyejnë shishe dhe të ecin zbathur mbi xhamë. Pastaj, në këmbët e çara, u fut kripë. Sidoqoftë, nënë, le t'i lëmë këto historira. Në fund të fundit për ty nuk janë dhe aq zbatitëse.

E dashura nënë! Ti më pyesje se kur do të vija me leje. Ku ta di unë? Luftë i thonë. Madje, me sa kuptoj unë, këtu e ndjejmë veten për çdo ditë më pak të sigruar... (Dëgjohet zëri i Ottos. Roberti e

fsheh letrën, rregullohet dhe merr drejtqëndrim. 'Otto hyn sëbashku me Lejtnantin (togerin) Ervin).

OTTO — (shumë nervoz.) Pardje ata plackitën dhe dogjën kolonën tonë që nisëm për në Qytet. Kurse mbrëmë, përpara hundëve, na vranë dhjetë ushtarë! Kjo është e padurueshme! (Robertit.) Po ti ç'më rri ashtu si shtyllë telefoni? Dil jashtë!

ROBERTI (merr drejtqëndrim.) Si urdhëroni, herr Oberst. Të dal jashtë. (del.)

OTTO — Kjo është fyese për ushtrinë ngadhni-jmtare të Hitlerit që i ka kallur datën tërë botës...! Dëgjo këu, Lejtnant! Unë dua që brenda njëzet e katër orëve të asgjësohet i tërë njesiti, përndryshe do t'ju pushkatoj.

ERVIN — (merr drejtqëndrim.) Hajl Hitler! I shërbuj Gjermanisë së madhe.

OTTO — Mos i kurseni plumbat. Vrisni dhe arrestoni sa të mundni.

ERVIN — Her Oberst! Ne pothuajse e kemi pushkatuar dhe arrestuar tërë Shqipërinë. Por ajo prapë ngrihet.

OTTO — (me përcëmim.) Ngrihet, ngrihet! Çdo të thotë ngrihet?... (mbush gotën me raki rrushi.)

ERVIN — Të gjithë kanë dalë partizanë. Në qytet s'ka mbetur njeri veç pleqve dhe fëmijëve.

OTTO — Të pushkatohen. Këta të gjithë janë bolshevikë. (ngre gotën e rakisë.) Këta maskarenj edhe shnapsin e kanë të fortë... Ulu, Lejtnant, ulu, (i jep një cigare.) Të shohim se çfarë do të na nxjerrë nga goja kjo pëllumbeshë.

ERVIN — Cila?

OTTO — E bija e atij doktorit, që ka mbaruar në Vjenë.

ERVIN — Héé, po! Thonë se babai i saj ka mjaft xhevahire...

OTTO — (sikur i tärheq vëmendjen.) Lejtnant...? Me sa jemi informuar, ai éshëtë jo më pak i krezikshëm se të tjerët!

Ervin — Ju dëgjoj, herr Oberst!

OTTO — (duke trokitur me të gotën e rakisë.) «Mos ki turp t'i gjakosësh brinjët robit» thuhet në bibël.

ERVIN — (qesh). Ha, ha, ha, ha... Ta gudulisësh me bajonetë...

OTTO — Mua një gjë më habit, Lejtnant, ku e gjen forcën të luftojë ky popull? Ç'e shtyn! I vogël, i pangrënë, i paarmatosur. E, me gjithatë, lufton!

ERVIN — Përpara se ta varrosja të gjallë Kop-shtarin, herr Oberst, atë plakun që e qëlluat me kamxhik surratit, i bëra këtë pyetje. E dini si m'u përgjegj? «Urrejtja për ar-mikun. Dashuria për Atdheun na bën të luftojmë» — më thotë.

OTTO — Dhe si vdiq?

ERVIN — Krenar!

OTTO — (Çohet me nervozizëm. Ervini mban drejt-qëndrim.) Djalli ta marrë. Sikur t'i kishim kaq të vendosur të gjithë ushtarët, ne me kohë do të vallëzonim Shtrausin mbi kurri-zin e botës, (i bie ziles. **Hyn Roberti.**)

ROBERTI — Jam nën urdhërat tuaja, herr Oberst.

OTTO — Ç'bën Hansi akoma? Pse s'e sjell atë. Ikë thuaji shpejt.

ROBERTI — Si urdhëron, herr Oberst. (**hyn në dhomën e torturave.**)

OTTO — Lejtnant! Që ky popull të mos ngrejë më krye duhet djegur.

ERVIN — Si urdhëron, herr Oberst. Duhet djegur. (**bie zilja e telefonit. Me shenjën e Ottos ai merr telefonin.**) Halo... Lejtnant Ervin... Këtu është. (**Ottos.**) Majori Lybke ju kërkon.

OTTO — (**Në telefon.**) Guerillet? Kë vranë... **Kemandantin e xhandarmërisë!** Me kë? Me spiunin Nr. 2! Po cili është ky? Alfredi! A, po! Ky qe i çmuar për ne... **Në djall të venë.** (**mbyll telefonin.**) Këta spiunë duhen zhdukur të gjithë. Përderisa ata sot tradhëtojnë bashkatdhetarët e tyre, nesër fare mirë mund të na tradhëtojnë edhe ne. A më kupton, Lejtnant?

ERVIN — Ju kuptoj fort mirë, herr Oberst... (**Në këtë moment N/Togeri Hans me Robertin sjellin Shpresën.** Nga pamja ajo të krijon përshtypjen se torturat e kanë rraskapitur. Por ajo përpinqet ta mbajë veten. **Nuk epet.**)

OTTO — (**me urtësi.**) Si e ndjeni veten, zonjë?

SHPRESA — Siç më shihni, kolonel. Fare mirë.

OTTO — Ju shqiptarkat jeni shumë krenare.

SHPRESA — Kurse ju nazistët tepër barbarë. (**Hansi ngre dorën për ta qëlluar.**)

OTTO — Hans...! Ulu, vajzë... (**në mënyrë provokuese.**) Sot ishte tek unë babai yt.

SHPRESA — (**Sa nuk i merren mendtë**) Babai!

OTTO — Po. Ai m'u duk njeri shumë i arësyeshëm dhe i kulturuar. Unë i premtova atij se do t'ju liroj, bile që sot, po të qe se ju do të na thoni, të paktën, se ku është strehuar

kryetari i njesitit. Asgjë më tepër. Të tjetrët i dimë.

SHPRESA — Asgjë më tepër?

OTTO — Vetëm kaq.

SHPRESA — Mirë, jua them. Meqenë se të tjerët i dini, po jua them. Por a do ta gjeni vallë?

OTTO — Vetëm një fjalë, për të tjerat mos u...

SHPRESA — Kryetarin e njesitit e mban populli.

OTTO — Po kush konkretisht?

SHPRESA — Populli? Populli është i madh. Pyeteni atë. Ai do t'ju përgjigjet.

OTTO — (në kulmin e nervozizmit, i bie me grusht tavolinës; por shpejt e përban veten.) Burri yt i dashur ju pret në shtëpi. Ai na i tha ç'kish për të thënë.

SHPRESA — Kolonel! Unë nuk e shkëmbej lirinë me dashurinë.

OTTO — E gjora vajzë! Heroizmi yt s'pi ujë. Ju keni mbetur vetëm.

SHPRESA — Edhe i vetëm mund të luftosh kur e di përse.

OTTO — Por ç'kuptim ka të luftosh kur lufta juaj tashmë ka marrë fund?

SHPRESA — (pasi i hedh një vështrim portretit të Hitlerit.) Kjo duket. Prandaj Adolf Hitleri na qenka kaq i gëzuar. (Kur përmendet emri i Hitlerit të gjithë oficerët marrin drejtqëndrim.)

HANSI — (si i xhindosur dhe i fyter.) Herr Oberst! Ma lini mua në dorë, pa di unë si ta bëj të flasë këtë bushtër.

OTTO — Vajzë! Mos përbuzni bukurinë tuaj...

SHPRESA — (ironizon.) Ju falem nderit për kujdesin, kolonel.

ROBERTI — Si urdhëron, herr Oberst. (hyn në dhomën e torturave.)

OTTO — Lejtnant! Që ky popull të mos ngrejë më krye duhet djegur.

ERVIN — Si urdhëron, herr Oberst. Duhet djegur. (bie zilja e telefonit. Me shenjën e Ottos ai merr telefonin.) Halo... Lejtnant Ervin... Këtu është. (Ottos.) Majori Lybke ju kërkon.

OTTO — (Në telefon.) Guerilet? Kë vranë... Komandantin e xhandarmërisë! Me kë? Me spiunin Nr. 2! Po cili është ky? Alfredi! A, po! Ky qe i çmuar për ne... Në djall të venë. (mbyll telefonin.) Këta spiunë duhen zhdukur të gjithë. Përderisa ata sot tradhëtojnë bashkatdhetarët e tyre, nesër fare mirë mund të na tradhëtojnë edhe ne. A më kupton, Lejtnant?

ERVIN — Ju kuptoj fort mirë, herr Oberst... (Në këtë moment N/Togeri Hans me Robertin sjellin Shpresën. Nga pamja ajo të krijon përshtypjen se torturat e kanë rraskapitur. Por ajo përpigjet ta mbajë veten. Nuk epet.)

OTTO — (me urtësi.) Si e ndjeni veten, zonjë?

SHPRESA — Siç më shihni, kolonel. Fare mirë.

OTTO — Ju shqiptarkat jeni shumë krenare.

SHPRESA — Kurse ju nazistët tepër barbarë. (Hansi ngre dorën për ta qëlluar.)

OTTO — Hans...! Ulu, vajzë... (në mënyrë provokuese.) Sot ishte tek unë babai yt.

SHPRESA — (Sa nuk i merren mendtë) Babai!

OTTO — Po. Ai m'u duk njeri shumë i arësyeshëm dhe i kulturuar. Unë i premtova atij se do t'ju liroj, bile që sot, po të qe se ju do të na thoni, të paktën, se ku është strehuar

kryetari i njesitit. Asgjë më tepër. Të tjetrët i dimë.

SHPRESA — Asgjë më tepër?

OTTO — Vetëm kaq.

SHPRESA — Mirë, jua them. Meqenë se të tjerët i dini, po jua them. Por a do ta gjeni vallë?

OTTO — Vetëm një fjalë, për të tjerat mos u...

SHPRESA — Kryetarin e njesitit e mban populli.

OTTO — Po kush konkretisht?

SHPRESA — Populli? Populli është i madh. Pyeteni atë. Ai do t'ju përgjigjet.

OTTO — (në kulmin e nervozizmit, i bie me grusht tavolinës; por shpejt e përmban veten.) Burri. yt i dashur ju pret në shtëpi. Ai na i tha ç'kish për të thënë.

SHPRESA — Kolonel! Unë nuk e shkëmbej lirinë më dashurinë.

OTTO — E gjora vajzë! Heroizmi yt s'pi ujë. Ju keni mbetur vetëm.

SHPRESA — Edhe i vetëm mund të luftosh kur e di përse.

OTTO — Por ç'kuptimi ka të luftosh, kur lufta juaj tashmë ka marrë fund?

SHPRESA — (pasi i hedh një vështrim portretit të Hitlerit.) Kjo duket. Prandaj Adolf Hitleri na qenka kaq i gëzuar. (Kur përmendet emri i Hitlerit të gjithë oficerët marrin drejtqëndrim.)

HANSI — (si i xhindosur dhe i fyter.) Herr Oberst! Ma lini mua në dorë, pa di unë si ta bëj të flasë këtë bushtër.

OTTO — Vajzë! Mos përbuzni bukurinë tuaj...

SHPRESA — (ironizon.) Ju falem nderit për kujdesin, kolonel.

OTTO — Për herë të fundit po ju them, tregoni.
Ndryshe do t'ju zhduk në mënyrën më të shëmtuar.

SHPRESA — Ju mua mund të më vrisni. Por Partinë dhe popullin tim nuk mund ta zhdukni kurrë.

OTTO — (e qëllon Shpresën.) Merre, Hans.

SHPRESA — (e pështyn në surrat) Pthu, kafshë.

OTTO — Hans! Nxirre jashtë, djalli ta marrë.
(Hansi dhe Roberti e nxjerrin Shpresën nga hyrja e majtë. Otto duke fshirë surratin.)
E, Lejtnant! E pe?

ERVIN — Si urdhëron, herr Oberst, e pashë.

OTTO — Ja ç'është dashuria e tyre për komuni-zmin. Ajo e tha qartë. «Partinë dhe popullin tim nuk mund ta zhdukni kurrë»

ERVIN — Pikërisht ashtu tha, herr Oberst. «Fjala e gjatë bën ditën e shkurtër» — thonë shqiptarët.

OTTO — Nuk thonë keq... Tash e tutje për çdo natë do të pushkatoj me dorën time nga një shqiptar... Kurse këtë këtu do ta le pér në fund. More vesh?

ERVIN — (merr drejtqëndrim.) Për Gjermaninë e madhe.

OTTO — Ky popull vetëm me terror mund të mposhtet.

ERVIN — Mund të shkoj, herr Oberst?

OTTO — Shkon. (Ervin del)... Akoma. Akoma s'dinë të vrasin ashtu si duhet këta guakët e mi.

ROBERTI — Majori Gynter kërkon të takohet me ju.

OTTO — Le të hyjë.

ROBERTI — Si urdhëron. (**nis të dalë.**)

OTTO — Na, prit. I thoni Hansit të pregatisë...

Nr. 100.

ROBERTI — Si urdhëroni, herr Oberst. Hansi të pregatisë Nr. 100.

OTTO — Shkoni. (**Roberti del. Hyn majori Gynter.**)

GYNTERI — (merr drejtqëndrim.) Gëzohem që ju shoh, herr Oberst.

OTTO — Gjithashtu, major.

GYNTERI — Kalova rastësishët këtej dhe thashë t'ju takoj.

OTTO — Qetësohuni... Uluni. (**mbush gotat e rakisë.**) Ç'kemi ndonjë të re?

GYNTERI — Sot, apo u informuam, herr Oberst, se brigada partizane e 18-të dhe batalioni i parë i brigadës 20-të, pasi morën zonën e Radinës, po lëvizin drejt Veriut në drejtim të qytetit.

OTTO — Lëri hollësitë, major. Më thuaj c'masa janë marrë.

GYNTERI — Të gjitha. Në pritje ka dalë regjimenti i dytë dhe i katërti me gjeneralin Shreder në krye, si dhe një batalion ballistësh. Drita e diellit do të eklipsohet nga zjarri i armëve tona. (Qeshin.)

OTTO — Më pëlqen optimizmi yt. (**Ngrenë gotat.**) Për lavdinë e Hitlerit.

GYNTERI — Hajl Hitler. (**Pinë.**)...! Shumë i fortë ky shnaps.

OTTO — Megjithëse e prodhon një popull i vogël.

ROBERTI — (duke hyrë.) Herr Oberst, Nr. 100 gati.

OTTO — Silleni!

ROBERTI — Si urdhëron.

GYNTERI — (cohet.) Mua do të më lejoni të largohem, herr.

OTTO — Mund të qëndroni, herr major. Mos e humbni këtë rast. Do të shihni një skenë interesante.

GYNTERI — Ju falem nderit por jam tepër i zënë. Ndonjëherë tjetër. Vetëm desha t'ju njoftoj, herr Oberst se, të dielën, organizohet në klub një darkë me rastin e dekorimit tim. Ju ftoj. Dhe do të gjëzoheshim shumë po të merrni me vete dhe kitarën.

OTTO — Oo, ju falem nderit, ju falem nderit, herr major. Do të vij me gjithë qejf.

GYNTERI — Me lejen tuaj mund të largohem. OTTO — Mund të shkoni, herr major.

GYNTERI — Aufidersen.

OTTO — Aufidersen. (Pas pak Hansi dhe Roberti sjellin Skënderin. Otto sikur nuk u beson syve se është ai.)

HANSI — Herr Oberst, numuri 100.

OTTO — E shoh. Nuk jam verbuar akoma, Hans.

HANSI — Më falni, herr:

OTTO — Për tri ditë e paskan transformuar fare këtë djalosh.

HANSI — I shërbej Gjermanisë së madhe.

OTTO — Nuk foli njeri me ju... Ulu, djalosh.

SKËNDERI — Unë mund të qëndroj në këmbë... Më mirë... kështu, ballë për ballë. Apo jo?

OTTO — Uluni këtu, djalosh... Ju keni nevojë për çlodhje. (ironizon.)

SKËNDERI — (gjithashtu me ironi.) Nuk është mirë aty, se i kthej kurrizin Adolf Hitlerit!

OTTO — (i ndodhur ngushtë.) Hans! Tregoji djaloshit se ku të ulet. (Hansi e godet Skënderin

me grusht dhe e ul në karrigën tjetër.) A
jeni mirë atje?

SKËNDERI — Prej këndeje mund të flas më lirisht.

OTTO — (Hansit dhe Robertit.) Më lerr.i vetëm.

HANSI dhe ROBERTI — Si urdhëroni. (dalin.)

OTTO — (shetit lart' e poshtë...) Më vjen keq për ty, djalosh... Kaq i ri... Edhe unë kam një djalë në moshën tënde.

SKËNDERI — (sheh kitarën.) Çudi!

OTTO — Ç'ka këtu për t'u çuditur!

SKËNDERI — Juaja është kjo kitarë?

OTTO — Po. Imja.

SKËNDERI — Çudi!

OTTO — Përse çuditesh!

SKËNDERI — Kitara pranë automatikut dhe hel-metës! Ç'kontrast!

OTTO — Dini t'i bini?

SKËNDERI — Ka kohë që s'i kam rënë.

OTTO — (merr kitarën dhe ja jep Skënderit.) Bini!

SKËNDERI — (tregon duart të lidhura me zinxhirë.) Me duar të lidhura s'i bihet kitarës, kolonel! Muzika kërkon liri. (Otto i bie ziles.

Në zyrë hyn Roberti.)

ROBERTI — Ju dëgjoj, herr Oberst.

OTTO — Zgjidhja duart! (i jep kitarën Skënderit.)

Na, bjeri diçkaje. (Skënderi i bie një akordi.)

O o o. Gut, gut. (Pastaj Skënderi merr so-

natën e Betovenit. Otto dëgjon me habi të

madhe. Gjatë kohës që Skënderi i bie kitarës,

në altoparlant dëgjohet zëri i Shpresës. —

«A nuk të duket ty, Skëndo, se në meloditë

e kësaj pjese - është fshehur lumtëria?... .

Sikur të fluturoja edhe unë si meloditë e

kësaj sonate».)

SKËNDERI — (duke i rënë më me forcë dhe pasion.) Dëgjoje, dëgjoje, dëgjoje, kolonel.
(Në këtë moment hyn Hansi.)

HANSI — Herr Oberst! Urdhëroni të pushohet kjo muzikë... Ajo nr. 105...

SKËNDERI — E shikoni, kolonel! Xhelatin e tërbon muzika. (vazhdon t'i bjerë kitarës.) Ajo rrон, rrон.

OTTO — (Mjaft i habitur.) Ju i bini Betovenit!

SKËNDERI — Po, kolonel, Betoveni është i vëgjilisë, jo juaji. Muzika e tij të zgjon, dhe nuk të mëson të bësh barbarizma, siç bëni ju me popullin tim. Me èndërrat dhe idealet me...

OTTO — Idealet dhe èndërrat tuaja i shfarosëm, i shtypëm përfundimisht.

SKËNDERI — Për një gjë të jeni të sigurt, kolonel, se èndërrat dhe idealet tonë as çizmet nuk mund t'i shtypin dhe as plumbat nuk mund t'i vrasin.

OTTO — Ju admiroj për guximin, për trimërinë tuaj... Gjynah të jeni komunist, djalosh. (Robertit.) Mbértheji sinxhirët... Shtrëngojë fort... Fort, fort, Robert!

SKËNDERI — (përpinqet ta mposhtë dhëmbjen.) A jeni i kënaqur, kolonel?

OTTO — C'njerez jeni ju? As vetja nuk i dhimbet!

SKËNDERI — Ne e duam shumë rininë tonë, kolonel. Por për ne s'ka gjë më të shtrenjtë se Atdheu.

OTTO — Po kujt i hyjnë në punë sakrificat tuaja?

SKËNDERI — Së ardhmes. (Hyn Hansi.)

OTTO — C'është?

HANSI — Herr Oberst! Pas torturash Nr. 105 u çmend.

OTTO — Nr. 105! I kujt është ky numër?

HANSI — I asaj.

OTTO — I kujt i asaj, Hans, thuaj emrin.

HANS. — I Shpresës.

SKËNDERI — I Shpresës! I Shpresës. (Në faqe i rrukullisen lotët.) I Shpresës, kolonel!

OTTO — (Skënderit.) Ha, ha, ha. Ti po qan?

SKËNDERI — Për këtë ti do të më përgjigjesh, goftë edhe në varr.

OTTO — (qesh.) Po merr përsipër një barrë të rëndë... Hans!

HANSI — Pres urdhërin tuaj, herr Oberst!

OTTO — (Me qartësi dhe ton ushtarak jep urdhërin.) Ajo të pushkatohet. Pastaj të hypet në një kafshë dhe të shetitet nëpër qytet, me qëllim që të tmerrohen banorët. Vetëm në këtë mënyrë do të mposhtet ky popull.

HANS — Si urdhëron, herr Oberst. I shërbej Gjermanisë së madhe. (del.)

SKËNDERI — (gjatë kohës që Otto jepte urdhërin, ai ka ardhur përparrë në avanskenë dhe ka tretur vështrimin në të kaluarën e tij. Lotët që i rrjedhin nga sytë, sikur ndjekin ritmin e melodisë së sonatës së Betovenit që dëgjohet diku larg, shumë larg.) Shpresa! Na e vranë dashurinë. Në prak të lumtërisë na e vranë. Por s'ka gjë. Rron Atdheu. Rron Partia. Të tjerët do të jetojnë të lumtur. Për brezat e ardhshëm paskëtaj s'do të ketë më as vuajtje, as fatkeqësi... (Mendimin ja ndërpresin dy të shtëna automatiku) Durim, Shpresa, durim. Mbaje kokën lart. (Prapë një breshëri automatikësh.) Komunistët vdesin, por nuk dorëzohen.

— Bie perdja —

Tablo VI

Oborri i Gestapos, i rrrethuar me tela me gjemba.
Një ushtar bisedon me rojën.

USHTARI — (tregon.) Në klub apo kish mbaruar darka. I ndjeri Otto, ashtu i gëzuar siç ish, u pëershëndet me oficerët e tjerë dhe doli. Ndërsa po hynte në maqinë, aty vetëtimthi vrapon një djalosh që bërtiti: «Herr Oberst! Në emër të popullit». Vetëm kaq dhe i zbrazi në kokë një karikatore me plumbë. Pastaj, pasi hodhi një bombë nga ato me tym, u zhduk... kështu u nda nga ne një nga oficerët tonë më të zotë.

ROJA — Pas asaj dite që shitetëm me kafshë ata komunistët që pushkatoi Hansi, banorët janë revoltuar shumë. Ata as që duan t'ja dinë për terrorin tonë.

USHTARI — Se si do të venë punët, as dreqi s'e merr vesh.

ROJA — (shuan cigaren dhe rregullohet.) Po vjen Roberti.

ROBERTI — (ushtarit.) Hej, ti! Si venë punët?

USHTARI — Gjithshka në rregull, herr rreshter. Të gjitha varret u hapën.

ROBERTI — Tërë varre u mbush ky vend e prapë s'varroset.

USHTARI — Më falni se po jua them, herr rreshter, por trimërisë dhe heroizmit të shqiptarëve është për t'ju pasur zilinë.

ROBERTI — (të cilit nuk i pëlqen mendimi i ushtarit, e urdhëron atë.) Gatit... Tri ditë

arrest, që të mësosh se si të flasësh tjetër herë.

USHTARI — Por unë, herr rreshter...

ROBERTI — Pushoni...! Prapa ktheu. Para marsh... Prapa ktheu, prapa ktheu, prapa ktheu. Para marsh! (Ushtari del. Në këtë kohë hyn një nënoficer që e ka parë skenën me ushtarin.)

NËNOFICERI — Ç'bëni ashtu, herr Robert? Po zbviteni?

ROBERTI — Po e mësoj si të flasë me eprorët, herr Shënberg.

NËNOFICERI — Ai mban kryqin e hekurt. Është ushtar shumë i mirë.

ROBERTI — Po gjuhën e ka të gjatë.

NËNOFICERI — (me urtësi.) «Bëj atë që duhet, mos vështro se ç'thuhet» thonë shqiptarët. (i ofron një cigare.) Ndize.

ROBERTI — Ju merreni me albanologji?

NËNOFICERI — Jo. Vazhdoj studimet për psikologji.

ROBERTI — Për psikologji! Gjë e bukur është psikologjia. Atëhere meqenë se jeni psikolog, herr Shenberg, si mendoni, a do të ndikojë para pushkatimit takimi i nënës në psikologjinë e komunistit nr. 100?

NËNOFICERI — (duke dalë me Robertin nga e majta.) Hansi është mjeshtër. Nga pikëpamja psikologjike ai e ka menduar shumë mirë këtë skenë. Unë mendoj se, më së fundi, nr. 100 do të dorëzohet. (Dalin. Në thellësi duket nëna që po e sjellin të shoqëruar. Njeriu me kostum të zi dhe një ushtar.)

NJERIU ME KOSTUM TË ZI — Zonja mësuese!

Ju jeni grua e nderuar. Mos e merrni veten
dhe atë në qafë.

NËNA — A mund të ulem të paktën?

NJERIU ME KOSTUM TË ZI — Posi! (i afro
një stol.) I thoni atij të mos tregohet krye-
neç, të...

NËNA — (si ndër dhëmbë.) Kush spiunon dheut
i rëndon.

NJERIU ME KOSTUM TË ZI — Si thatë?

NËNA — Thashë kush spiunon dheut i rëndon.

NJERIU ME KOSTUM TË ZI — Bëjuni e arësy-
eshme, mësuese. Nga qëndrimi juaj varet
qëndrimi i djalit tuaq:

NËNA — Dhe nga qëndrimi i djalit varet qën-
drimi im.

NJERIU ME KOSTUM TË ZI — Tamam ashtu
është. Por ju mund të ndikoni.

NËNA — Mjaft. Silleni shpejt djalin.

NJERIU ME KOSTUM TË ZI — (fërkon duart.)
Pas pak do ta keni këtu!

HANSI — (hyn me të bërtitura) Ku është Roberti?
Robert! Robert.

ROBERTI — Këtu jam, herr...

HANSI — Ku djallin futesh.

ROBERTI — Kontrollova gropat, herr.

HANSI — Në rregull.

ROBERTI — Gjithshka në rregull. Sa më thellë
hapan, aq më tepër kufoma duan. Janë gojë
që s'ngopen. (Qeshin të dy.)

HANSI — Ikë tani, prepatit skuadrën.

ROBERTI — Si urdhëron, të pregatis skuadrën.
(del.)

HANSI — (njjeriut me kostum të zi, pasi shikon
nënën.) He? Çdo të na thoni?

NJERIU ME KOSTUM TË ZI — Në rrëgull, herr Hans. Ky takim, me sa duket, do të jetë për ta shumë tronditës.

HANSI — Rëndisi ka përfundimi.

NJERIU ME KOSTUM TË ZI — Tek e fundit, ne s'humbasim gjë.

HANSI — (I indinjuar.) Si s'humbasim gjë? Ne humbasim shumë, zotni.

NJERIU ME KOSTUM TË ZI — (me ton pajtues.) Më falni për keqkuptimin, herr Hans. Desha të them...

HANSI — S'është nevoja për shpegime. E kam të qartë. Shkoni silleni tani.

NJERIU ME KOSTUM TË ZI — Si urdhëron. (del.) Pas tij shkon edhe ushtari qe solli nën.

HANSI — (Me veic.) I ndjeri Otto kish të drejtë kur thosh se spiunët përderisa tradhëtojnë atdheun e tyre, edhe ne mund të na tradhëtojnë në çdo moment. (Në thellësi dëgjohet zëri i trumpetës që shoqëron hapin e skuadrës së pushkatimit. Në këtë kohë hyn nënoficeri.) Hë psikolog! Besoj se kini zbuluar mjaft material, për temën tuaj.

NËNOFIGERI — (merr drejtqëndrim.) S'kam përsë të ankohem, herr Lieutenant!

HANSI — Sidomos kjo e sotmja do të jetë një skenë interesante.

NËNOFIGERI — Ashtu mendoj dhe unë, Lieutenant! (Duket skuadra e pushkatimit që vjen në komandën e Robertit. Ajo radhitet diku në një vend të dukshëm, para së cilës qëndron krenare nëna. Njeriu me kostum, të zi sjell Skënderin të lidhur me pranga.)

NËNA — (sa sheh Skënderin.) Skëndo, trim i nënës!

SKËNDERI — Mbaje veten, nënë.

HANSI — (bën me shenjë nga Skënderi.) Zgjidhini duart dhe lëreni të takohet... Psikolog! Eja këtu.

SKËNDERI — (Sa i zgjidhin duart, vërsulet për të puthur nënën) Nëna ime e ëmbël! Sa më ka maqrë malli! Sa i lumtur jam sot!

NËNA — Si qenke bërë, të keqen nëna, kockë e lëkurë.

SKËNDERI — Si janë shokët? Si vete lufta?

NËNA — Përparojnë. Shokët dhe lufta pérparojnë.

SKËNDERI — Po Shpresa, Shpresa!

NËNA — Shpresa ra ashtu siç u ka hije komunisteve. (qan.)

HANSI — (të tijve.) Ajo po qan. Gjithshka në rregull, herr psikolog. (Skënderit dhe nënës.) Hej ju atje, përfundoni shpejt.

NËNA — Bir...! Revolucionari në momente revolucionare e tregon veten e tij. Ti erdhe gjer këtu; qëndro.

SKËNDERI — (për të mos i rënë në sy së emës, fshehurazi fshin lotët.) Nënë! E dashura nënë! Fshiji lotët... Fshiji lotët, nënë. Nuk është mirë kështu! Armiku sheh... Fshiji lotët, nënë ime e mirë... Ne do të rrrojmë edhe kur të vdesim... Fshiji lotët, nënë...

NËNA — (duke e puthur.) Falem nderit, bir, falem nderit.

HANSI — Mjaft u puthët. (Skënderit.) Ç'ke përt'i thënë?

SKËNDERI — Vetëm një gjë. (Njeriu me kostum të zi bëhet gati të mbajë shënim.)

HANSI — më së fundi.

SKËNDERRI — (njeriut me kostum të zi.) Shkruaj.

Vetëm pér një gjë më vjen keq dhe kërkoj ndjesë nga populli dhe Partia se s'kam vrarë aq armiq sa duhej.

HANSI — (i çakërdisur, e godet Skënderin fytyrës.) I poshtër. Të mësoj unë se si të flasësh. (e godet prapë. Nëna mbylli sytë me pëllëmbë. Pastaj Hansi i drejtohet nënës.) Po ti ç'ke pér të thënë?

NËNA — (krenare.) Ate që tha im bir.

HANSI — O zot! Këta as varrit s'i tregojnë. (ushtarakëve të tjerë pér Skënderin.) Nxirreni dhe pushkatojeni! (duke bërë me shenjë nga nëna.) Ndërsa këtë këtu do ta përkëdhel me kërbaç gjersa ti dalë shpirti. (Kur e nxjerrin Skënderin, skuadra e pushkatimit bëhet gati pér veprim. Ajo me hap të shtrire del nga krahu, ku do të kryhet ekzekutimi.)

SKËNDERRI — (duke dalë, i drejtohet nënës.) Lamtumirë. Lamtumirë, nëna ime e shtrenjtë!

NËNA — Durim, të keqen nëna.

ROBERTI — (komandon skuadrën e pushkatimit.) Gatit! Armë mbushi! Gati pér zjarr... zjarr!

NËNA — (që sheh me sy këtë veprim, me zë të fortë thotë: komunistët bien, por nuk dorëzohen. Në këtë moment skuadra e pushkatimit, me bajoneta të zhveshura, sipas komandës së Robertit, rrethon nënën. Nëna ngrihet në një pedium mbi bajonetat naziste, si një monument i ndriçuar nga drita e një prozhektori të fortë. Skuadra e pushkatimit, e tmerruar nga kjo pamje, avash e hap rrë-

thin përderisa shuhën dritat dhe bien si-pari. Në skenë prapë vendoset lapidari, përpara të cilët qëndron gruaja e veshur me të zeza. Ajo thotë:

— Ja, kjo është historia e kësaj dashurie të përgjakur, kujtimin e së cilës e mban të gjallë ky lapidar.

ZERA — (nëpërmjet altoporlantit.) Po me babanë e Shpresës ç'u bë?

GRUAJA E VESHUR ME TË ZEZA — Unë nuk e di; kur u këtheva nga kampet naziste të përqëndrimit, mësova se ai, pasi kish parë me sy tragjedinë e së bijës, kish rrëmbyer pushkën dhe kish rënë duke luftuar dhëmb për dhëmb me gjermanët. (Në këtë çast nga salla çohet në këmbë një oficer. Është babai i Shpresës.)

MAJORI — Jo, mësuesë. Unë jàm gjallë. Unë jetova që të mbroj atë përgjithë cilën dhanë jetën Skënderi, Shpresa e mijëra itë tjerë.

GRUAJA E VESHUR ME TË ZEZA — Doktor! (Majori ngjitet në skenë, përqafon gruan e veshur me të zeza dhe në shenjë mirënjohjeje gjunjëzohet para saj. Ajo duke mos e lënë majorin të gjunjëzohet, i drejtuhet spektatorit.) Ju e patë! Për Atdheun ne sakrifi-kuam gjithshka. Por kur ta dojë nevoja ne jemi gati të japim edhe jetën tonë. Dhe tani natën e mirë. Bëfshi gjumë të ëmbël.

FUND

Tiranë 1963.

46996